

**WIND**  
**CALL YOUR COUNTRY**  
 TELEFONO NË SHQIPËRI DUKE FILLUAR  
 ME NGA 5 QINDARKA NË MINUTË  
 INFORMAZIONE WIND.IT

# Bota shqiptare

www.shqiptariitalise.com

**WIND**  
**CALL YOUR COUNTRY**  
 TELEFONO NË SHQIPËRI DUKE FILLUAR  
 ME NGA 5 QINDARKA NË MINUTË  
 INFORMAZIONE WIND.IT

**il mondo albanese**  
 IL GIORNALE DEGLI ALBANESI IN ITALIA  
 Quindicinale - Anno XIII - Nr. 266  
 16 - 30 settembre 2011 € 1,50

Iscrizione Registro Stampa del Tribunale di Roma nr. 213/99 del 12.05.99 (cambiamenti in corso). Iscrizione ROC nr 13252. Direttore Responsabile Roland Sejko Stampa: CSQ - Centro Stampa Quotidiani S.p.A Erbusco, BS. Distribuzione nazionale edicole: Messaggerie Internazionali SpA. Tariffa R.O.C.: Poste Italiane s.p.a. - Sped. A.P. - D.L. 353/2003 (L. 46/2004) art.1, c.1,1 - CNS/AC - Roma

ISSN 1720-3678  
 0 0 2 6 6  
 9 771720367001

Redazione: Via Eleonora Duse 53, 00197 Roma. Tel 06-94354511 Fax 06-97998632. Email: botashqiptare@stranieriinitalia.it



## Çelësi i artë i suksesit të MILOTIT

Alfred Mirashi, ose Milot siç njihet në mjediset e artit, është një prej mijëra shqiptarëve të ardhur në Itali me eksodin. Endërsa në forma nga më të ndryshmet këtë vit përkujtohet 20 vjetori i kësaj ngjarjeje, një skulpturë e artistit shqiptar është vendosur përpara pallatit të Kinemasë me rastin e festivalit të Filmit, në kuadrin e ekspozitës me titullin Open

## Hidhet në erë gjyqtari Konomi

Më 9 shtator Skerdilajd Konomi, gjyqtari në Gjykatën e Shkallës së Parë në qytetin e Vlorës, ka mbetur viktimë e hedhjes në erë të veturës që ngiste.

faqe 2-3



## Medalje heroit Blerim Shkrepi

Medalje e argjendtë për vlera qytetare Blerim Shkrepi, që në dhjetor të vitit 2008 shpëtoi një fëmijë nga flakët. "Do ta kish bërë kushdo", thotë i bindur.

faqe 9



**shqiptariitalise.com**  
 portali i komunitetit shqiptar në Itali

**WESTERN UNION** | **yes!**

**Bota shqiptare**

il giornale degli albanesi in italia

testata vincitrice del premio giornalistico M. Souhir  
per la multiculturalità nei media come  
MIGLIOR GIORNALE PER GLI STRANIERI IN ITALIA

viti XIII i botimit / anno XIII

E përdyjavshme informative-  
kulturore e shqiptarëve në  
Itali.

QUINDICINALE DI INFORMAZIONE  
E CULTURA DEGLI ALBANESI IN ITALIA.

BOTIM I / EDITORE

Keti Biçoku  
Via Domenico Ragona 41,  
00143 Roma

Regjistruar në Regjistrin e  
Shtypit të Gjykatës së Romës  
me dekret

TESTATA ISCRITTA AL REGISTRO  
STAMPA DEL TRIBUNALE DI ROMA  
n. 213/99 del 12.05.1999

REDAKSIA / REDAZIONE  
Via Virgilio Maroso 50,  
00142 ROMA

Tel. 06-94354511  
Fax 06-97998632  
Cell. 393-9712595

www.shqiptariitalia.com  
botashqiptare@stranieriitalia.it

DREJTOR/DIRETTORE RESPONSABILE  
Roland Sejko

REDAKSIA / REDAZIONE  
Keti Biçoku, Irida Cami

BASHKËPUNËTORË/ COLLABO-  
RATORI  
Rando Devole, Giuseppe  
Chimisso, Albana Temali,  
Afërdita Shani,  
Ivan Muccari (grafico)

LEGISLACION EMIGRACIONI  
LEGISLAZIONE D'IMMIGRAZIONE A  
CURA DI  
Stranieri in Italia srl, Roma  
www.stranieriitalia.it

REKLAMAT  
Tel. 06-94354505  
pubblicita@stranieriitalia.it

SHTYPI / STAMPA  
Centro Stampe Quotidiani spa  
Via dell'Industria 52,  
25030 Erbusco (BS)

Shpërndahet në të gjithë  
Italinë në pikëshitjet me  
shtyp në gjuhë të huaj

DISTRIBUZIONE NAZIONALE  
NELLE EDICOLE DI STAMPA ESTERA  
Messaggerie internazionali SpA  
Via A. Manzoni, 8  
20089 Rozzano (MI)  
Tel. 02-57512612

DORËSHKRIMET NUK KTHEHEN.  
ARTIKUJT E PANËNSHKRUAR JANË  
TË REDAKSISË

# ATENTAT ME TRITOL NË VLORË VRITET GJYQTARI

**N**jë shpërthim i fuqishëm tritoli i ka marrë jetën një gjyqtari në Vlorë. Ngjarja e rëndë ndodhi në orët e para të mëngjesit të 9 shtatorit në rrugën kryesore. Makina e 33-vjeçarit, Skerdilajd Konomi, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, ka shpërthyer sapo ai ka lëvizur automjetin, të cilin e kishte të parkuar. Dëshmitarë në vendngjarje pohojnë se 33-vjeçari ka arritur të dalë nga automjeti, e më pas është transportuar drejt spitalit rajonal. Dëmtimet kanë qenë të shumta, në organe, por



edhe gjymtyrë. Si pasojë e gjendjes dhe dëmtimeve të rënda, ai ka humbur jetën. Nga shpërthimi nuk ka patur të lënduar të tjerë.

Benci me targa VI 6383 B fillimisht është tronditur nga shpërthimi i fortë, e pas kësaj është përfshirë nga flakët. Policia nisi punën për zbardhjen e ngjarjes por deri tani kuk jepet asnjë version zyrtar në lidhje me sulmin, por gjithsesi profesioni i viktimës nuk ka përjashton mundësinë e ndonjë sulmi për shkak të detyrës. Skerdilajd Konomi punonte si gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë në Vlorë prej rreth 6 vjetësh.

## ELEGJI PËR SKERDILAJD KONOMIN

**Nga Altin Stafa, Bolonjë**

**S**a mënyra ekzistojnë për të vranë një njeri? Plumbi (me apo pa silenciator); thika, e shurdhër, (natën, pas shpine në një qoshe rruge, apo ditën, në bark në mes të turmës së zhurmshme); helmi, shekspirian, (femëror o rivalësh për pushtet a dashuri); varja (show makabër); karrigia elektrike (amerikane); aksidenti i sajuar (modern)... Kaini zgjodhi gurin për të vranë Abelin. Ka kush preferon tritolin. Tritoli të bën copash me shumë zhurmë e rrëmujë. Tremb foshnjat në gjumë dhe ata në barkun e nënës. E transmeton kumtin e vdekjes larg, tek shumë njerëz, në shumë media. Është në të njëjtën kohë vrasës dhe lajmëtar i vdekjes që pjell.

Më 23 maj 1992, në rrethinat e Palermos, 5 kuinalë tritol hodhën në erë makinën ku udhëtonte gjykatësi italian anti-mafia Giovanni Falcone.

Pesë kuinalë tritol nuk krijojnë thjesht një varr të thellë në tokë për viktimën fatkeqe. Ai shpërthim mbi të gjitha gjeneron frikë dhe terror tek të gjallët që i dëgjojnë zhurmën, tek ata që marrin kumtin e tij.

Thonë se vdekja të tmerron më shumë kur të kalon pranë, se sa kur vjen e të merr.

Këtë ndoshta e dinë mirë ata që në 9 shtator 2011, në mes të Vlorës, hodhën në erë me gjithë makinë gjykatësin shqiptar Skerdilajd Konomi. Në qoshen tonë të Ballkanit, të ngjizur me luftëra, me plumba, me vdekje, me gjakmarrje kanunore, me dhunë të të gjitha llojeve, lajmi i një gjykatësi të masakruar vetëm tre ditë zgjat...E në këtë qoshen tonë të Ballkanit, ai njeriu i mirë, por i lodhur me shekuj rrëmujë gjaku, të thotë: "S'ke ç'bën! Kështu jemi ne... nuk ia vlen as të indinjohesh. Asgjë nuk ndryshon..."

Nuk ia vlen te indinjohesh, se asgjë nuk ndryshon!!!Po të paktën, ulërit! Ulërit deri në

„  
Pesë kuinalë tritol nuk krijojnë thjesht një varr të thellë në tokë për viktimën fatkeqe. Ai shpërthim mbi të gjitha gjeneron frikë dhe terror tek të gjallët që i dëgjojnë zhurmën, tek ata që marrin kumtin e tij

kupë të qiellit që të mbytysh ulërimën e tritolit! Ulërit, se po ta vranë ligjin, do të vazhdojmë ta tjerim ekzistencën tonë ballkano-fisnore në një xhungël dhune barbarësh pa kokë e pa fund. Ulërit! Reago si bishë ndaj bishave, se në Ballkan pak tjetër paska mbetur. Nuk është njerëzore të mësohesh me vdekjen e dhunshme në mënyrë kaq fa-

taliste. Është ballkanike, por nuk është njerëzore.

Vrasja e Skerdilajd Konomit nuk është thjesht krim ndaj një njeriu. Ajo është dhunë e kimit të organizuar ndaj shtetit, ndaj ligjit, ndaj shoqërisë civile. Madje është edhe më tepër. Skerdilajd Konomi i përket atij brezi që u lind në të shuar të viteve '70 e që u zgjua i rritur pa bunker në kokë, atij brezi që e fitoi natyrshëm dimensionin civil të jetës. Ndryshe nga brezat që i paraprinë, ai brez vetëm sa e ceku shkruambajnë sociale e shpirtëror të trashëguar. E ndjeu zjarrin, por nuk u dogi prej tij. Ai brez nuk u indoktrinua, nuk u fëlliq, nuk u deformua, nuk spiunoi për të mbijetuar, nuk e shiti shpirtin. Mbese nuk arriti ta bënte dot, sepse koha e fali ose ndoshta sepse fati e ruajti për një tjetër kohë.

Të lindurit në shtatëdhjetecanë patën fatin ta ruanin të lirë mendimin e tyre dhe patën mundësinë t'a ngjyenin këtë mendim të lirë në lirinë qindrvajçare të botës së madhe. Për këtë arsye, është krejt natyrale shpresa se kthesa e vërtetë në botën shqiptare duhet të fillojë të vijë nga ky brez.

Tritoli i 9 shtatorit 2011 nuk hodhi në erë vetëm trupin e Skerdilajd Konomit. Ai tritol kërkoi të mbyset brezin e shpresës. Të tmerrojë shokët dhe kolegët e Skerdilajdit, por dhe të gjithë ata njerëz që e

## Më 9 shtator Skerdilajd Konomi, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë në qytetin e Vlorës, ka mbetur viktimë e hedhjes në erë të veturës që ngiste. Hetohet në dy pista, mbi dosjet që po gjykonte, dhe mbi mosmarrëveshje mbi pronat. Ngjarja e paprecedentë në Shqipëri tronditi mbarë opinionin publik. U konsiderua nga presidenti Topi "sulm mafioz ndaj sistemit të drejtësisë, shtetit ligjor dhe demokracisë në Shqipëri". Deri më sot nuk ka asnjë person të akuzuar për atentatin

### Hetimet

Hetimet për zbardhjen e shpërthimit tragjik vazhdojnë në dy pista: vrasja për shkak të detyrës, dhe tjetra më kryesorja vrasje për motive pronësie. Përgjatë këtyre ditëve të para të pas ngjarjes, grupi hetimor ka pyetur dhjetëra dëshmitarë okularë të ngjarjes, të cilët kanë shpjeguar gjithçka panë në bulevard kur makina shpërtheu dhe i mori jetën babait të dy fëmijëve. Në duart e prokurorëve ndodhen dhe dëshmitë e familjarëve të Konomit dhe të afërmve të tjerë. Po ashtu mësohet se gjatë dy ditëve të fundit hetuesit kanë pasur biseda dhe me

kolegë të Skerdilajd Konomit. Grupi i hetimit ka qenë tejet i rezervuar për të nxjerrë detaje të këtyre dëshmiave që konsiderohen kyçe në zbardhjen e ngjarjes.

### Reagimet

I menjëhershëm reagimi i Presidentit të Republikës, Bamir Topi, dhe i shumë autoriteteve të tjera.

Presidenti dënoi ashpër aktin kriminal që ndodhi në Vlorë, duke thënë "atentati ndaj një gjyqtari përbën kërcënim për shoqërinë dhe institucionet e shtetit", se "ky sulm mafioz dhe brutal është një atentat ndaj sistemit të

”

Pushteti gjyqësor në vendit tonë është duke pritur që sa më parë organet e hetimit, të bëjnë të ditur emrat e autorëve të këtij krimi makabër, si edhe t'i vendosin ata, kushdo qofshin, përpara drejtësisë; është duke pritur të bëhet drejtësi jo vetëm për Gjyqtarin Konomi, por mbi të gjitha të vendoset në vend autoriteti shtetëror i cenuar dukshëm nga ky akt

drejtësisë, shtetit ligjor dhe demokracisë në Shqipëri".

Brenda ditës Presidenti priti Prokuroren e Përgjithshme, Ina Rama, Drejtorin e Shërbimit Informativ Shtetëror (SHISH), Bahri Shaqiri dhe Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Hysni Burgaj.

**Kryeministri Sali Berisha** dënoi aktin e shëmtuar kriminal që mori jetën e gjyqtarit, Skerdilajd Konomi, dhe kërkoi nga organet kompetente gjetjen dhe vendosjen para ligjit të autorëve dhe organizatorëve të këtij akti mizor. Ai u shprehu ngushëllimet dhe solidaritetin e tij, si dhe të qeverisë, ndaj familjes Konomi dhe trupës gjyqësore të vendit.

**Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Kreshnik Spahiu**, në një konferencë shtypi, dënoi dhunën ndaj gjyqtarëve, nëpërmjet këtij ekzekutimi terrorist, i cili nuk ndodh dhe nuk duhet të ndodhë në asnjë vend, ku funksionon rendi, siguria dhe shteti ligjor. "Ky akt është në vazhden e disa ngjarjeve, atentateve dhe veprave të dhunshme kundër gjyqësorit përgjatë viteve të fundit dhe përbën një rast të paprecedent në historinë e drejtësisë shqiptare".

"Shqipëria synon të jetë pjesë e Bashkimit Evropian dhe të jetë në udhën e Brukselit dhe jo në Sicilinë e 50 viteve me parë, ku drejtësia gjunjëzohet përballë veprave mafioze dhe krimi të organizuar. Një shtet ligjor, i cili nuk mund të garantojë jetën e gjyqtarëve, nuk mundet të japë garanci për jetën e qytetarëve të thjeshtë dhe nuk mundet të garantojë dhënie e drejtësisë nga ata, të cilët kërcënohen me jetë dhe humbasin jetën rrugëve të Shqipërisë", tha Spahiu.

Ai kërkoi që "kjo çështje të trajtohet me prioritet maksimal nga organet e hetimit dhe të gjenden dhe të vendosen para drejtësisë autorët e kësaj masakre kriminale".

"Ky akt mafioz është një goditje për sistemin e drejtësisë, një sulm i drejtpërdrejt dhe i egër, i cili duhet të sjellë reflektim të menjëhershëm të shtetit për të marrë masa në mbrojtje të sigurisë së jetës së

gjyqtarëve", tha Spahiu, ndërsa i shprehu ngushëllimet familjes së të ndjerit. Vetëm pak ditë më pas ai iu kthye sërish çështjes: "Pushteti gjyqësor në vendit tonë është duke pritur që sa më parë organet e hetimit, të bëjnë të ditur emrat e autorëve të këtij krimi makabër, si edhe t'i vendosin ata, kushdo qofshin, përpara drejtësisë; është duke pritur të bëhet drejtësi jo vetëm për Gjyqtarin Konomi, por mbi të gjitha të vendoset në vend autoriteti shtetëror i cenuar dukshëm nga ky akt. Pothuajse në të gjitha rastet krimet e rënda ndaj njerëzve të sistemit të drejtësisë ka mbetur pa autor. Një precedent i tillë duhet të ndryshojë urgjentisht".

**Shoqata e Prokurorëve të Shqipërisë**, përmes këtij mesazhi ngushëllimi, dënoi "ngjarjen më të rëndë të ndodhur ndaj një përfaqësuesi të sistemit të drejtësisë në vendin tonë".

Shoqata u bëri apel kolegëve të tyre prokurorë, që po merren me hetimin e kësaj ngjarjeje, të bëjnë të pamundurën për zbardhjen sa më shpejt dhe vënien para drejtësisë të autorëve të këtij krimi mafioz të pashembullt. "Gjyqtarët, prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore dhe punonjësit e tjerë të sistemit të drejtësisë, pavarësisht kësaj ngjarjeje tejet të rëndë, do të vazhdojnë të tregojnë angazhim maksimal duke qëndruar të palëkundur në luftën ndaj krimi", thuhet në mesazhin ngushëllues të prokurorëve shqiptarë.

Edhe **Unioni i Gjyqtarëve të Shqipërisë**, (UGJSH) me një deklaratë u shpreh se "sulmi ndaj gjyqtarit Konomi është sulmi më i egër, pas disa sulmeve të tjera verbale dhe fizike, që i është bërë ndonjëherë sistemit gjyqësor në Shqipëri. Ky sulm, me mënyrën, kohën dhe vendin e ekzekutimit të tij, duke mbjellë një klimë terrori të pashembullt, ka për synim jo vetëm terrorizimin dhe frikësimin e sistemit gjyqësor por, mbi të gjitha goditjen, terrorizimin dhe frikësimin e të gjithë sistemit të drejtësisë, agjencive të zbatimit të ligjit dhe cënimit e sundimit të ligjit në vend".

**Partia Socialiste**, përmes një deklaratë për shtyp, dënoi sulmin mafioz në qytetin e Vlorës, dhe kërkoi nga drejtësia që autorët e këtij krimi të marrin dënimin e merituar. "Ngjarje si kjo, ku dora e krimi nuk ngurron të sulmojë e vrasë përfaqësuesit më të lartë të këtij shteti janë të papranueshme dhe përbëjnë një sinjal alarmi për mbarë qytetarët e këtij vendi", thuhet në një deklaratë të PS-së.

"Drejtësia duhet të veprojë me forcë për të nxjerrë sa më shpejt autorët e këtij krimi të shëmtuar përpara përgjegjësisë dhe për t'u rezervuar atyre dënimin e merituar për këtë vrasje mafioze", përfundon deklaratë e PS-së.

përbuzin atë llum të murmë e me erë të keqe që kërkon të mbulojë shoqërinë shqiptare. Ajo vdekje shpërthyesë kërkon të mbyllë gojën e atyre që nuk durojnë dot më të jetojnë në inercinë ballkanofisnore. Skerdilajd Konomi mund ta kishin vrasur edhe me një plumb të vetëm. Por e shpërthyen me tritol, sepse deshën që vdekja e tij të dëgjohet larg, që tmerri të zhytej në çdo ëndërr a dëshirë shqiptare për normalitet.

Po kjo nuk durohet! Atëherë ulërin! Ulërin, se po ju vrasin djemtë më të mirë, po ju vrasin shpresën. Ulërin, se po pastrojnë mbi ju këpucët e fëlliqura me atë llumin e murmë që mban erë të keqe. Në këto kohë krizash globale, bursash të lajthitura e politikanë që u ngjajnë bursave, në këto kohë fqinjësh që gjunjëzohen para botës por që nuk ta heqin litarin nga fyti, në këtë kohë kur asnjë katastrofë natyrore nuk ta prish më gjumin, sa mund të rezistojë tmerri i masakrit me tritol të gjykatësit shqiptar Skerdilajd Konomi?

"Mafia nuk është e pa-  
thyeshme. Mafia është dukuri njerëzore dhe si e tillë ajo ka një fillim, por ka edhe një fund. Vetëm se duhet kuptuar që ajo është një dukuri jashtëzakonisht e rëndë dhe serioze. Mafia nuk mund të mposhtet duke pretenduar heroizma nga qytetarë të pafajshëm, por duke futur në

veprim forcat më të mira të institucioneve të një Shteti".

Giovanni Falcone, gjykatës italian anti-mafia, i vrasur me 5 kuintalë tritol në 1992.

Në botën tonë, gjërat me të vërtetë të reja janë jashtëzakonisht të rralla ...



# Irene Pivetti në Vlorë: "NUK KE VEND KËTU!"

Shoqata e familjarëve të viktimave të Katër i Radës në Vlorë nuk ia ka harruar ish-kryetares së Dhomës Italiane të Deputetëve Irene Pivetti fjalët që ka thënë ditëve të tragjedisë. Pivetti u kërkon falje shqiptarëve

**P**a dyshim që nuk e priste reagimin e një grupi qytetarësh të Vlorës ish-kryetarja e Dhomës Italiane të Deputetëve Irene Pivetti. Si promovuese dhe organizatorja e nismës së notarit Massimo Voltolina për të përshkuar me not kanalën e Otrantos, ajo zhvilloi një sërë takimesh me autoritetet vendase dhe me kryetaren e Kuvendit Shqiptar Juzefina Topalli.

Por ndërsa në nivel institucional do jetë shoqëruar nga shtrëngim duarsh dhe fjalë të ngrohta e falënderime, Irene Pivetti u përball me qëndrimin e ashpër të të afërmeve të viktimave të Katës i Radës apo të së Premtes së Shenjtë. Të atyre që në fund të kanalit të Otrantos kanë humbur një herë e përgjithmonë buzëqeshjen.

Pushime Çala, një mesogrua e veshur me të zeza prej 14 vjetësh, kujtoi atyre që patën harruar ose nuk

deshën të kujtojnë fjalët e Irene Pivetti të nesërmen e mbytyjes së Katër i Radës. Në mars të vitit 1997, duke folur në Parlament për të mbijetuarit e tragjedisë ajo deklaroi "Hidhini në det se u kthjellohen mendimet". Prandaj me një kurajë që dëshpërimi apo dhimbja mund të japin, Pushime Çala ia ka thënë në sy ish-deputetes se në Vlorë ajo është e padëshiruar.

Me gjithë ndjesën publike që Irene Pivetti kërkonte, përfaqësuesja e të afërmeve të viktimave nuk pranoi t'i jepte dorën. Me sa duket falja e saj nuk zuri vend edhe pse me zë të mallëngjyer tha: "Kërkoj falje për deklaratat e nxituara. Mua më vjen keq, shumë keq për atë çka u ndodhi familjeve tuaja dhe juve personalisht. Nuk mund të qëndrosh indiferente ndaj një dhimbjeje të tillë, si në Shqipëri, Itali apo vende të tjera. Unë jam e nderuar për këtë takim, sepse ashtu siç kam bërë

dhe herë të tjera, dua të shpreh dhimbjen dhe solidaritetin ndaj popullit shqiptar sot, për atë ditë. 20 vjet më parë marrëdhëniet mes dy vendeve kanë qenë të ndryshme, kishte një klimë e tension të lartë politik dhe jo vetëm politik. Nga ana ime dhe e shumë të tjerëve nuk ka pasur një nënkuptim agresiv, por ka qenë një pakënaqësi. Nuk ka pasur asnjë urrejtje nga ana ime për shqiptarët, ishte thjesht një tension i fortë politik mes dy vendeve. Besoj se çdo shqiptar me vullnet të mirë do e kuptonte këtë".

Pra ka pranuar se deklarata e asaj kohe ka qenë e nxituar. Por ndoshta shumë më e nxituar qe vizita e saj në Vlorë e në Shqipëri, ku herë të tjera që përkëdhelur në shtëpitë e pritjes dhe që ndërë rehat në kolltukët luksozë të institucioneve më të larta të shtetit shqiptar.

Irida Cami

## NGA SHTYPI SHQIPTAR

# IRENE PIVETTI...

# Po sikur ta hedhim ne në det?

**V**izita në Shqipëri e ish-kryetares së Parlamentit të Italisë Irene Pivetti, ishte një rast i jashtëzakonshëm për familjarët e viktimave të tragjedisë së Otrantos për të demonstruar me gjithë forcën e dhimbjes së tyre një indignatë edhe fisnike, edhe thelbësisht shqiptare.

Irene Pivetti, 48 vjeç, është sot një gazetare pasi ka qenë deputete e Italisë për të paktën 10 vjet, e në mes të kësaj dekade (nga viti 1992 deri në 2001) edhe kryetare e dhomës së ulët të deputetëve në Itali. Në vigjilje të tragjedisë së Otrantos së vitit 1997, ose më saktë tre ditë para asaj tragjedie, deklaroi në Kuvendin italian ku përfaqësonte Lega Nord që "nëse Italia nuk arrin të ndalojë emigrimin e shqiptarëve brenda brigjeve dhe tokës së saj, atëherë më mirë ti hedhim ata sërish në det!".

Ngaqë fati ndonjëherë është edhe ironik po aq sa është dhe tragjik, tre ditë pas asaj deklarate "Kateri i Radës" u mbyt në Gjirin e Otrantos, një tragjedi ajo që shqiptarët zor se mund ta harrojnë kollaj. Një proces i gjatë juridik, shumë i anatemuar për mungesë drejtësie ndaj familjarëve të viktimave u bë pjesë e shtypit të përditshëm dhe e historisë së përbashkët të dy popujve që ndahen prej mijëvjeçarësh nga një rrip i ngushtë deti që ka prodhuar historikisht tragjedi. Po të ndalemi dhe njëherë tek Irene Pivetti, që dje takoi kërret më të lartë të shtetit, por teksa po hynte në



zyrat e Dhomës së Tregtisë së Vlorës u ndalua nga familjarët të viktimave të Otrantos të cilët e detyruan të kërkonte ndjesë për deklaratat e saj.

Në vitin 2007, gazeta prestigjioze italiane "La Repubblica" shkruante se deklarata e zonjës në fjalë: "t'i hedhim shqiptarët në det" është një prej momenteve historike të racizmit italian të shprehur nga goja e një politikaneje. Pak ditë më vonë, një gazetar i "Corriere della sera" intervistoi Joseph Ratzinger, që sot është Papa Benedikti i VI dhe teksa e pyeti se cilat ishin komentet e tij në lidhje me atë deklaratë, Ratzinger bëri një reagim gati shokues për botën e gazetarisë: "Obobo... ashtu ka thënë vërtet?" E pas kësaj heshti... duke mos pranuar të jepte komente të mëtejshme!

Aktivistë të shumtë për të drejtat e njeriut kërkan pas asaj deklarate nisen e një hetimi për racizëm, ndonëse Casini, një tjetër politikan edhe ai jo me pak problematik në Itali, kërkonte

"mëshirë"! Por as edhe tragjedia e Otrantos nuk e detyroi zonjën Pivetti, motër e aktorese Veronica Pivetti, që të tërhiqej nga qëndrimi i saj. "Pse? Mos i hodha gjë unë në det ata...?" tentoi të mbrohej ajo, duke mos treguar as shenjë më të vogël të pendesës.

E rritur në një familje që në thelb nuk ka patur asnjë histori specifike në lidhje me racizmin, Pivetti konsiderohet sot në Itali, si një politikane e rënë nga vakti. Pas përvojës së saj në Parlament, duket se e ka braktisur politikën për t'iu përkushtuar në frontin e parë gazetarisë. Punon në një televizion italian pikërisht si gazetare, pra si një person që fjalët i ka lëndë të parë të punës së saj, e që me të cilat nuk mund të bëjë dot as shaka, e as t'i mohojë dot.

Dje, teksa kishte vizituar Shqipërinë për një aktivitet në dukje "maratonmak" por që në thelb të vetin ka interesa ekonomike për të bërë biznes në Shqipëri, Pivetti u ndal në rrugë nga familjarët të viktimave të tragjedisë së Otrantos. Në sy të medias, ata i thanë: "Sot keni helmuar tokën shqiptare. Në vitin '97 ju keni kërkuar që shqiptarët të hidhen në fund të detit dhe pikërisht pas tre ditësh një anije me 115 shqiptarë në bord përfundoi në fund të detit. Sot është helmuar vendi ynë njëlloj si atë ditë që humbëm njerëzit tanë", tha një grua shqiptare tërë dinjitet, forcë e guxim, e cila përfaqësonte shoqatën "Otranto".

Kristi Pinderi

## Itali-Shqipëri me not, në më pak se 24 orë

Massimo Voltolina ia del mbanë: përshkon me not kanalën e Otrantos dhe mbërrin në Orikum një ditë pasi është nisur nga Punta Palascia

**N**otari 43-vjeçar Massimo Voltolina arriti të përshkojë me not Kanalën e Otrantos duke fituar një sfidë që ndoshta do të mbetet në historinë e sportit. Ai u nis nga Punta Palascia në orën 14:26 të 4 shtatorit dhe mbërriti në Vlorë një ditë më pas, më 5 shtator, në orën 14:18; rreth 24 orë not në det të hapur.

Fillimisht ai notoi i qetë, por vështirësitë i hasi në 7-8 orët e fundit për shkak të kushteve të këqija të detit. Megjithatë ai arriti të përshkojë 85 kilometrat që ndajnë dy brigjet e Adriatikut.

Është llogaritur që gjatë notimit drejt Shqipërisë muskujt e shpatullave të Massimo Voltolinës janë kontraktuar mbi 100 mijë herë.

Evenimenti sportiv u promovua nga shoqata "Learn to be free" e Irene Pivetti. Për të pritur Voltolinën në portin turistik të Orikumit në Vlorë kishin dalë veç të tjerëve edhe, vetë Pivetti, zëvendësministri shqiptar i Turizmit dhe konsulli italian në Vlorë.

Voltolina është një prej protagonistëve italianë të sfidave ekstreme në not. Ne vitin 2006 ai ka përshkuar për 13 orë e një minutë Kanalën e la Manshit duke vendosur rekordin kombëtar. E ky i Kanalit të Otrantos është një tjetër rekord.

Një përpjekje të ngjashme bëri në gusht të vitit 1985 edhe Paolo Pinto, i cili u mposht nga kushtet e këqija të detit.

## ZYRË SHËRBIMESH, KONSULENCE DHE PËRKTHIMESH

Përkthime të Autorizuara me Apostille nga Italia ose Shqipëria të Certifikatave të Lindjes për regjistrimin e fëmijëve në Zyrat e Gjendjes Civile në Shqipëri, të Certifikatave Familjare, Martesore, Penale për shtetësinë italiane, Përkthime Prokurash Speciale, Diplomash, Konvertime Patentash, Nulla osta për martesë, Informacione nga interneti mbi pasaportat biometrike, Viza pranë Ambasadave të ndryshme, etj. Dokumentet nisen me postë dhe brenda pak ditësh Ju arrijnë në adresën që dëshironi. Cell. 327.8848348

# SHQIPËRIA ËSHTË GJITHNJË MË PRANË.



## CALL YOUR COUNTRY

FLET ME SHQIPËRINË ME 5 QINDARKA NË MINUTË ME NUMRAT E RRJETIT FIKS,  
10 QINDARKA NË MINUTË ME CELULARËT.  
FALAS NË PROMOVIM KOSTOJA SEMESTRALE PËR 6 MUAJT E PARË.

DHE ME **SUPER NOI WIND** ÇDO JAVË  
KE 400 MINUTA DHE 400 SMS E MMS ME TË GJITHË NUMRAT WIND  
ME VETËM 3€ NË JAVË DHE PA KOSTO AKTIVIZIMI.



AKTIVIZO CALL YOUR COUNTRY  
ME NJË SMS FALAS  
DUKE INKUADRUAR KODIN  
ME SMARTPHONE-N TËND



AKTIVIZO SUPER NOI WIND  
ME NJË SMS FALAS  
DUKE INKUADRUAR KODIN  
ME SMARTPHONE-N TËND

Zgjidh Wind. Duke telefonuar në 155, dëgjon risitë dhe merr asistencë në gjuhën shqipe.

PËR MË SHUMË INFORMACIONE MBI KOSTOT, KUSHTET DHE KUFIZIMET, SHKO NË WIND.IT

Call Your Country: Shkrehje në përgjigje 16 cent. Tarifimi çdo 60 sekonda. Kosto semestrale 4€. Për klientët e rinj aktivizimi i Call Your Country 7€, falas deri më 2/10/2011. Super Noi Wind është e vleshme për telefonatat drejt numrave Wind në Itali.

  
**WIND**  
Più vicini.

Nga Ilvo DIAMANTI

**K**ëtë vit në Festivalin e Venecias, kinematografia italiane, pas shumë vjetësh u bë sërish protagoniste. Çmimi i jurisë iu dha filmit "Terraferma" i Emanuele Criales. Çmimi për veprën e parë më të mirë: "Là-bas" i Guido Lombardi. Të dy filmat kanë një subjekt të përbashkët: imigrantët. Filmi i Criales: eksodin e të dëshpëruarve që ikën nga Afrika Veriore, i parë me sytë e peshkatarëve sicilianë.

Filmi i Lombardit: përjetimet dramatike të imigrantëve në revoltë në Castelvoturno, në vitin 2008. Por veprat e paraqitura në Venezia nga regjisorët italianë, mbi këtë temë janë të shumta. Në të gjitha seksionet e festivalit. Janë mbi dhjetë. Të përmendim vetëm disa. "Cose dell'altro mondo" i Francesco Paterno, i cili hedh hipotezën (shkatërruese) të zhdukjes së imigrantëve në një zonë verilindore të vendit. E më tej: "Storie di schiavitù" i Barbara Cupisti, "Io sono Li", i Andrea Segre (ndër të tjerët interpreton Marco Paolini), "Villaggio di Cartone", i shkruar dhe i drejtuar nga një maestro: Ermanno Olmi. Deri tek filmi "L'ultimo terrestre", i Gipi, që rrefen për mbërritjen e alienëve mes nesh. Ku alienët janë "të tjerët, ata që theksojnë brishtësinë tonë. Ndjenjen tonë të të qenit në periferi".

Të dërguarit e gazetës Le Monde (Jacques Mandelbaum dhe Philippe Ridet), kanë vënë re se për kinematografinë italiane imigracioni është kthyer në një "zhanër më vete". E mbi këtë ide kanë realizuar një reportazh të zgjeruar me titullin shumë domethënës: "Imigrantët, roja amerikane e Festi-

# SIGURIA

## Mendimi i vetëm i mediave mbi imigracionin

**Në Festivalin e Venecias, kinematografia italiane u bë sërish protagoniste. Fiton Çmime, me dy filma që kanë një subjekt të përbashkët: imigrantët. Padyshim ka ndikuar synimi për të "sfiduar" Mendimin e Vetëm të përcjellë nga mediat dhe nga propaganda e populizmit të djathtë - me influencë në shumicën në pushtet. Frika ndaj Tjetrit është kthyer nga mediat në temë për fitimin e konsensusit dhe të publikut televiziv. Por hendeku mes agjendës mediatike dhe shqetësimeve të qytetarëve mbetet i thellë**

valit të Venecias". Nga ana tjetër është e vështirë, e pamundur të gjehet në Evropë - dhe gjetkë - një vëmendje kaq e thellë - gati si fiksim - si ajo e shprehur nga kinemaja italiane ndaj të huajve. Megjithëse e shtyrë nga ndjenja qytetare dhe solidarë, nuk arrin të mbulojë pakënaqësinë e përhapur, në një vend emigrantësh ku imigracioni ka mbërritur papritur. Dhe ku brenda më pak se 10 vjetësh është rritur 1000%. Sot është rreth 7% (në shifra absolute rreth 5 milionë, sipas Caritas-Migrantes), por arrin deri në 20% në zonat më të industrializuara të Qendrës dhe Veriut (Lombardia, Emilia Romagna, Toscana, Nordest). Megjithatë "masat" reale të fenomenit nuk

mjaftojnë për të shpjeguar kaq shumë ndjeshmëri nga ana e regjisorëve dhe autorëve italianë të kinemasë. Intelektualë dhe specialistë - ndonjëherë dhe artistë - të komunikimit. Vëmendja e të cilëve diktohet me siguri nga "lënda" që ofron tematika. Biografitë dhe historitë e jetës së imigrantëve, takimi me komunitetet vendase, me "italianët".

Por ndoshta më shumë ka ndikuar synimi për të "sfiduar" Mendimin e Vetëm të përcjellë nga mediat dhe nga propaganda e populizmit të djathtë - me influencë në shumicën në pushtet. Frika ndaj Tjetrit si temë për fitimin e konsensusit - dhe audiencës. Mjafton të vëzhgohen të dhënat e Obser-

vatorit Evropian të Sigurisë (nën kujdesin e Demos, Observatorit të Pavia dhe Fondacionit Unipolis). Në edicionet e lajmeve në kanalet shtetërore në disa vende të rëndësishme evropiane (Italia, Franca, Spanja, Gjermania dhe Britania e Madhe), gjatë katër muajve të parë të vitit 2011, lajmet lidhur me imigracionin kanë zënë 3% të totalit. Më në veçanti: tek Franca 2 kanë përfaqësuar 1,6%, në ARD (rrjeti shtetëror gjerman) 0,6%, tek të tjerat akoma më pak. Tek Tg1, përkundrazi, 13,9%. (E njëjta kuotë arrihet gjithashtu duke llogaritur edhe lajmet e kanaleve të tjera italiane, shtetërore dhe private). Natyrisht, Italia është vendi ku "revolucionet" afrikanoveriore

e, mbi të gjitha ndërhyrja në Libi kanë pasur më shumë impakt. Me ndryshimin që gjetkë në Europë këto ngjarje janë trajtuar si fakte dhe episode lufte. Ndërsa në Itali janë trajtuar në mënyrë specifike nga pikëvështrimi i imigracionit. Ose më mirë (apo më keq), të pushtimit. Elementi i parë dhe kryesor i përdorur nga Lidhja e Veriut për të argumentuar kundërshtimin e saj ndaj ndërhyrjes në Libi.

Megjithatë, me gjithë zbatimet e luftërave në bregun tjetër mesdhetar, hendeku ndërmjet agjendës mediatike dhe shqetësimit të qytetarëve, mbetet shumë i madh. Mjafton të konsultohen sërish të dhënat e Observatorit Evropian të Sigurisë duke u përqendruar këtë herë tek perceptimi social. Imigracioni cilësohet si shqetësim kryesor për 6% të italianëve (nga kampioni përfaqësues i anketuar nga Demos në qershor të 2011). Anketat më të mëdha të italianëve ama mbeten tematikat që kanë të bëjnë me ekonominë, punësimin, koston e jetesës (55%). Shikimi i medieve mbi imigrantët pra duket asimetrik në krahasim me atë të popullatës. E njëjta gjë ndodh me kriminalitetin, i cili mbetet në qendër të informacionit televiziv (55% e informacioneve të mbrëmjeve), ndërsa nga ana tjetër shqetëson një pjesë shumë më të vogël të popullatës (10%). Bëhet fjalë për një "ndërtim" politik dhe mediatik të pasigurisë, gjë që shtyn drejt enfatizimit të "frikës ndaj të tjerëve" dhe drejt pakësimit të pasigurisë për arsye ekonomike dhe të (pa)punësimit. (Nga ana tjetër pesimizmi ekonomik është komunist dhe anti-italian, ka

## LEGA NDËRRON MENDIM

### Tatim të remitançave edhe për emigrantët e rregullt

**Në Dhomën e Deputetëve, Lega pranon që tatimi prej 2% mbi dërgesat në par atë imigrantëve të parregullt në atdhe është i kotë. Zgjidhja? Të goditen të gjithë të huajt, edhe ata me leje qëndrimi. Qeveria lëkundet**

**M**ë në fund e kanë kuptuar edhe legistët, por vetëm tani e pranojnë publikisht, që tatimi i remitançave që futën në manovrën ekonomike nuk do të sjellë as edhe një qindarkë për arkat e shtetit.

Sipas çka është miratuar deri tani, tatimi prej 2% do të rëndojë vetëm mbi dërgesat në para të kryera nga shtetas të huaj me qëndrim të parregullt në Itali. Kategori kjo që, në të vërtetë, sipas një pakete sigurie të të njëjtës qeverie, të miratuar dy vjet më parë, nëse guxon të transferojë para në rrugë të ligjshme rrezikon të denoncohet e për rrjedhojë të dëbohet.

Por klandestinët e kanë zgjidhur ndryshe, dërgojnë para në vendlindje me anë të miqve dhe të

afërmeve me lejeqëndrimi apo duke përdorur kanale jozyrtare. Hile këto që do të përdorin aq më shumë tani, për të shmangur edhe tatimin.

Më 14 shtator në Dhomën e Deputetëve diskutohet konvertimi në ligj i manovrës së re ekonomike. Teksti u blindua nga qeveria duke kërkuar votëbesim, kështu që shumë prej kërkesave për modifikime të tij u konvertuan në rend dite: praktikisht deputetët i kërkojnë qeverisë të marrë përsipër angazhime, edhe pse në të vërtetë nuk mund ta detyrojnë t'i kthejë në realitet.

Tre deputetë legistë (Alessandro Montagnoli, il capogruppo Marco Reguzzoni e Laura Molteni) kanë paraqitur një rend dite kushtuar

pikërisht normës së futur nga ata vetë: asaj mbi tatimin e remitançave. Në tekst shpjegojnë që do të godasë të parregullt, por kujtojnë edhe që sipas një ligji mbi sigurinë (edhe ky i Legës) të huajt me qëndrim të parregullt u qëndrojnë larg pikave të *Money transfer-it*.

Pas këtij zbulimi të madh, kanë kërkuar që qeveria të marrë masat. Në ç'mënyrë? Duke ndërmarrë "iniciativa të tjera normative për rishikimin e normës lidhur me transferimin e parave me qëllim që të shtrijnë dispozitat e tanishme (pra tatimin me 2% të shumave të dërguara në atdhe) edhe për subjektet me matrikull INPS dhe kod fiskal". Me fjalë të tjera, duan të tatonjë edhe remitançat e imigrantëve të rregullt.

## REFORMA E SHTETËSISË DHE E TË DREJTËS SË VOTËS

### Nis mbledhja e firmave

**Depozitohen propozimet e ligjeve të fushatës "Italia jam edhe unë". Brezat e dytë menjëherë italianë, në zgjedhje administrative të gjithë të huajt me qëndrim të rregullt prej pesë vjetësh**

**N**ë fillim të shtatorit janë depozituar në Kasacion dy propozime për ligj me iniciativë popullore për reformimin e ligjit të shtetësisë dhe për t'u dhënë të drejtën e votës administrative imigrantëve. Nis praktikisht kështu fushata "Italia jam edhe unë", e promovuar nga 19 shoqata mes të cilave Acli, Arci, Caritas, Cgil, Fondacioni Migrantes dhe Sei Ugl, të bashkuara në një komitet të kryesuar nga kryebashkiaku i reggio Emilias Graziano Delrio.

Reforma e shtetësisë duhet të përgjysmojë kohën e natyralizimit, pra duke e çuar nga dhjetë në pesë vjet rezidencë të rregullt. Risia kryesore ka të bëjë me brezat e dytë: duhet të jetë italian kush lind në Itali nga një prind me qëndrim të rregullt këtu prej të paktën një viti apo nga një prind i lindur në Itali, por edhe kush frekuenton një cikël shkollor apo kur vjen në

Itali me moshë deri në dhjetë vjeç dhe qëndron këtu deri kur mbush moshën madhore.

Ndërsa propozimi mbi të drejtën e votës parashikon që edhe imigrantët me rezidencë të rregullt në Itali prej të paktën pesë vjetësh të jenë zgjedhës aktivë dhe pasivë në zgjedhjet për minibashkitë, komunat, provincat dhe krahinat. Për të pasur këtë të drejtë, ata duhet të regjistrohen në një listë elektorale të posaçme, siç bëjnë sot qytetarët komunitarë për të marrë pjesë në zgjedhjet komunale.

Me depozitimin në Kasacion të dy teksteve, mund të nisë mbledhja e firmave. Nevojiten 50 mijë të secilin propozim për ta paraqitur më pas në Parlament. Në Romë, ditët e ardhshme do të ngrihet një stendë ku kanë paralajmëruar se do të jenë të pranishëm eksponentë të botës së kulturës, spektaklit dhe të politikës që përkrahin përmbytjen e fushatës.



Imigracioni konsiderohet si shqetësim parësor vetëm nga 6% e italianëve. Problemet e qytetarëve duket se janë të ndryshme nga ato të mediave. Qytetarët janë të shqetësuar kryesisht për tema që lidhen me ekonominë, punësimin dhe koston e jetesës (55%). Përqendrimi i vëmendjes së mediave mbi imigracionin, duket se shkon në kah të kundërt me shqetësimet e qytetarëve. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për kriminalitetin, që mbetet në qendër të lajmeve në televizion (55% e lajmeve mbrëmjes, prime time), ndërkohë që preokupon një kuotë shumë më të reduktuar të popullsisë (10%).

Është fjala për konfirmim të "ndërtimit" politik dhe mediatik të pasigurisë, që sjell mëshimin e "frikës ndaj të tjerëve" dhe pakësimin e paqartësive për arsye ekonomike dhe të (pa)punësimin.

përsëritur kryeministri edhe kohët e fundit).

Por në këtë fazë nuk më duket se "të tjerët" kufizohen vetëm me imigrantët që mbërrijnë në Itali të shtyrë nga nevoja apo emergjencat. Në kushte të vështira, ndonjëherë dramatike. Sot në Itali po përhapet një sindromë e rrethimit më e zgjeruar dhe e pacaktuar. Ndihejmi të kërcënuar nga jashtë, nga çdo front e drejtim. Nga revoltat e luftërat që shpërthejnë në vendet e Afrikës së Veriut dhe në Lindjen e Mesme. Por edhe nga Europa e mbi të gjitha nga Gjermania. Që nuk besojnë në ekonominë, e mbi të gjitha në sistemin tonë politik. E kërcënojnë që të mos mbulojnë borxhin tonë shtetëror, të mos blejnë aksionet tona shtetërore. Ndihemi të kërcënuar nga bursat dhe Tregjet, nga Spread dhe S&P. Ne, që kemi kultivuar gjatë identitetin tonë kombëtar të bazuar mbi artin e përshtatjes, mbi aftësinë e të rregulluarit dhe të reagimit. Ne që jemi konsideruar një shoqëri "e gjallë"-pavarësisht nga qeveria, pavarësisht nga Shteti. Sot e ndiejmë veten pa busull. Jetimë të një qeverie që të dijë të qeverisë dhe të një Shteti ku mund të kesh besim. Kështu ndihemi të huaj në vendin tonë. Kjo është arsyeja, ose: njëra prej arsyeve të rëndësishme të kaq shumë filmave italianë mbi imigrantët këtë vit në Venecia.

Në të vërtetë flasim për ne. Të humbur e pa drejtim në vendin e Terraferma-s.

*Marrë nga La Repubblica ku është botuar me titullin "Quei film sugli immigrati nel Paese di Terraferma"*

lindurve. Por nëse këtyre shifrave u shtojmë edhe të lindurit nga çiftet e përziera arrihet në 102 mijë për 2009-tën dhe 207 në 2010, përkatësisht 18% dhe 19% të të gjithë të lindurve.

Tashmë në krahina të ndryshme të veriut të Italisë vërehet që të lindurit me të paktën një prind të huaj janë një ndër katër. Në Emilia Romagna, për shembull, në vitin 2009, ndër 100 të lindur 29 kanë pasur të paktën një prind të huaj.

Renditja e nënave të huaja në Itali, sipas numrit të fëmijëve të lindur nis me rumune, marokene dhe shqiptare. Të lindurit në vitin 2009 me nënë rumune janë 16.727, me nënë marokene 14.370, shqiptare 9.937.

Duke vërejtur shtetësinë e prindërve sipas përbërjes së çiftit bie në sy që marokenet, shqiptaret, kinezet janë të prira të ndërtojnë familje me fëmijë me partnerë të komunitetit të tyre, ndërsa gratë ukrainase, polake, moldave, ruse e kubane janë të pritura të kenë fëmijë me italianë më shpesh se me bashkatdhetarë. Nuk vlen një diskutim i tillë për rumunet: renditen të parat si nëna që bëjnë fëmijë me partnerë italianë por sidoqoftë në dy të tretat e rasteve bëjnë fëmijë me partnerë bashkatdhetarë.



ndërsa të sapolindurit me të paktën një prind të huaj vazhdojnë të shtohen, edhe pse me ritëm më të ulët se më parë: rreth 5 mijë më shumë në vitin 2009 dhe në 2010-tën, rritje e përgjysmuar krahasuar me atë që vërehet në vitin 2008.

Të lindurit me të dy prindërit e huaj gjatë vitit 2009 janë 77 mijë, ndërsa në vitin 2010 78 mijë, diçka më pak se 14% e të gjithë të

## Bie numri i lindjeve, "fajin" e kanë italianët

**Bijtë e imigrantëve shtohen nga viti në vit, ndërsa për ata të italianëve ka nisur rënia. Të dhënat ISTAT**

Imigrantët "përpiqen" me të gjitha forcat, por nuk ia dalin dot më të ngrenë grafikun e lindjeve në Itali, pas stimi të fjongove rozë e të kaltra të viteve të fundit, kthehet sërish shenja minus. E gjitha "për faj" të italianëve.

E nxjerr në dukje ISTAT, që të mërkurën ka botuar një raport mbi "Lindjet dhe fertiliteti i popullsisë rezidente" të dy vjetëve të fundit. Të dhënat e viteve 2009 dhe 2010 konfirmojnë që vazhdon rënia e numrit të lindjeve: nëse të lindurit në vitin 2009 kanë qenë 568.857, në 2010-tën kanë zbritur në 561.944, rreth 7 mijë më pak. Rritja e ngadaltë por e vazhdueshme e lindjeve e nisur në vitin 1995, vit ku i regjistrua edhe minimumi historik i lindjeve (526.06 të lindur), duket tashmë e ndërprerë.

Istat vë në dukje që rënia shkaktohet nga pakësimi i lindjeve nga prindër që të dy italianë (25 mijë më pak në dy vjet),

## "Në gjunjë përpara migrantëve" Olmi rrëfen mikpritjen

**Në Venecia regjisori i filmit "Villaggio di cartone", historia e një kishe që kthehet në vendstrehim për klandestinët. "Katolikët të kujtohen që janë të krishterë, nuk mund të gjunjëzohen përpara kryqit dhe të mos jenë solidarë me ata që vuajnë"**



Nuk duhet të gjunjëzohesh përpara kryqit që është vetëm një shëmbëlltore kartoni, por përpara atyre që vuajnë si imigrantët". Është leksioni i mjeshtrit Ermanno Olmi, që të martën, më 6 shtator ka paraqitur në Venecia, jo në konkurrim, filmin e tij "Il villaggio di cartone" ("Vendi prej kartoni").

Filmi tregon historinë e një prifti të moshuar dhe të kishës së tij të braktisur, nga e cila hiqet çdo gjë, deri edhe kryqi. Por ajo ndërtesë tashmë e boshatisur që mbushet me migrantë në kërkim të një vendstrehimi, duke rilindur në një jetë të re, do t'i japë një kuptim të ri misionit të priftit dhe do të kthehet në një metaforë efikase e mikpritjes.

"Sa më shumë kisha dhe ne çlirohemi nga xhinglat, aq më mirë është. Përndryshe jemi maska, njerëz prej kartoni" tha Olmi në konferencën e shtypit, pas shfaqjes së filmit që u shoqërua nga duartrokitje të gjata. "Dua t'u sugjeroj katolikëve, dhe unë jam një ndër ta, të kujtohen gjithnjë e më shpesh që janë edhe të krishterë. Tempulli i vërtetë është komuniteti njerëzor" shtoi regjisori.

Një gazetari që e pyeti nëse në këtë mënyrë katolicizmi reduktohet vetëm në mikpritje, Olmi iu përgjigj: "A mund të jeni aq i sjellshëm sa të më thoni çfarë është më e

rëndësishme se mikpritja? Çfarë? Shenjtëria e simboleve? Simboli duhet të të çojë në një realitet të vërtetë për të pasur vlerë. Nuk është e mundur që të gjunjëzohemi përpara një Krishti prej kartoni e pastaj të mos jemi solidarë me ata që vuajnë. Është tepër e thjeshtë kështu".

Në kishën e Vendi prej kartoni bashkëjetojnë e mira dhe e keqja, siç tregon prania mes migrantëve e një terroristi, që do të bindë një të ri të mbathë brezin me ekspoziv. "Filmi im nuk është realist - shpjegoi regjisori - dhe çdo prani është simbolike. Djali, i sugjestionuar nga fjalët e terroristit, vendos të pranojë aktin e dhunshëm si një detyrim për të mos dialoguar me tjetrin. Njësoj si sakrestani që denoncon klandestinët sepse ka frikë të hapë derën e shtëpisë pa pyetur: kush



je? Nga vjen? Vetëm duke u përballur dhe duke dialoguar me të tjerët mund të kuptojmë kush jemi".



A I KE SHTATË  
LIQENET E LURËS  
NË KOPËSHT?



SIGNORINA,  
UNA  
SCHEDINA!

MUND  
TË FITOSH  
JACKPOTIN  
MILIONER.



**SuperEnalotto** 

ËNDËRRIMTAR LIND,  
MILIONER BËHESH.



Nëse nuk ke mbushur 18 vjeç, nuk mund të luash.

**Medalje e argjendtë për vlera qytetare, të riut shqiptar që në dhjetor të vitit 2008 shpëtoi një fëmijë nga flakët. "Do ta kish bërë kushdo", thotë i bindur**



# MEDALJE për heroin modest

**M**e ndjenjë të lartë altruizmi dhe i vetëdijshëm për rrezikun, nuk hezitoi të futej në dhomat e mbytura nga tymi të një shtëpie ku kish rënë zjarri, duke shpëtuar një fëmijë të ngërthyer mes flakëve. Shembull i pastër solidariteti dhe virtytesh të shquara qytetare".

Është ky motivimi i dëshmisë që shoqëron medaljen e argjendtë për vlera qytetare të dhënë të martën, më 6 shtator, Blerim Shkrepi, që tre vjet më parë në Arona të provincës së Novarës shpëtoi një fëmijë nga flakët. Në ceremoni kanë marrë pjesë kryebashkiaku i qytetit të vogël, prefekti i Novarës dhe shumë miq e të afërm. Shkrepi, i emocionuar për vlerësimin e lartë, thotë për shqiptariitalise.com se nuk e priste aspak këtë medalje pasi sipas tij "kushdo do të kish bërë të njëjtën gjë".

Atë natë të fundit të dhjetorit 2008, ishte në një dyqan duke punuar kur dëgjoi njerëz të shqetësuar që kërkonin ndihmë. Doli jashtë e pa që në një vilë përballë kish rënë zjarri. Një grua thoshte se brenda i kish mbetur i biri 6 vjeç dhe i shoqi kish hyrë për ta

## BLERIM SHKREPI

kërkuar. "Nuk e zgjata fare, dhe hyra në vilë. Ishte errësirë dhe duke ecur ngadalë me duart përpara papritur preka djalin, Niccolò. E mora në krahë e dola jashtë". "Ishte rastësi që e gjeta unë dhe jo i ati" shton duke i ulur vlerën gjestit të tij.

Pasi u sigurua që fëmija ishte mirë, dhe duke mos menduar se kish bërë një gjest të veçantë mori furgonin e tij dhe iku në shtëpi. "Vetëm më pas mora vesh që gazetaret e televizionet po flisnin për mua. Isha bërë heroi i ditës, gazetarët më kërkonin për intervista, njerëzit në rrugë më përgëzonin".

Blerimi sot është 27 vjeç. Jeton në Galliate nga viti 2002, kur në moshën 18 vjeçare u largua nga Shqipëria e erdhi të jetojë në Itali ku kishte vëllezër e motra. Në fillim u mbështet tek ta, deri filloi të punojë e të jetojë më vete. Sot punon privatisht,

bashkëpunon me një ndërmarrje mobiljesh. "Kam një furgon dhe dorëzohet e montoj mobilie në shtëpi".

Ke hasur vështirësi si i huaj? "Jo, jo - thotë - Nuk them se s'kam ndier asnjëherë racizmin, por kur nuk ia vë veshin e shkon në rrugën tënde e ke më të lehtë. Unë kam bërë gjithnjë kështu".

Po sot ndihesh hero? "Kush unë? E ç'kam bërë? Askush nuk do të qëndronte indiferent përpara një shtëpie në flakë! Ndoqa instinktin: hyra brenda, gjeta Niccolò dhe e nxora jashtë. Vetëm kaq!".

Nga ceremonia e dhënies së medaljes ka vetëm një pishman: "Do të më kishte pëlqyer të ishin të pranishëm edhe djali që shpëtova e prindërit e tij. Por ndoshta kanë harruar t'i ftojne".

Keti Biçoku

## Elvira Dones prezanton "Piccola guerra perfetta" në Milano e Torino

**S**humë shpejt shqiptarët por edhe lexuesit italianë të dashuruar pas letërsisë së Elvira Donesit në Lombardia dhe Piemonte kanë rastin të takojnë shkrimtaren që prezanton romanin e saj të fundit "Piccola Guerra perfetta", me parathënie të Roberto Savianos.

Dones është një nga penat shqiptare që ka ditur të rrëfejë e të perceptojë me nuhatje të hollë temat shqiptare. Por në krijimtarinë e saj nuk ka vetëm Shqipëri. Duke filluar që nga autobiografiku "Dashuri e huaj" e deri tek i fundit "Lufta e vogël e përkryer" lexuesit i ofrohet një mozaik copëzash Shqipërie, por edhe Ballkani, copëzash historie të dokumentuara nga afër në mënyrë të gjallë me jetët e personazheve të saj.

Në Milano, takimi me shkrimtaren do të mbahet në Sallën Grechetto të Pallatit Sormani (via Francesco Sforza, 7), të premtën më 23 shtator në orën 19.00. Takimi organizohet nga Qendra e Kulturës shqiptare në bashkëpunim me shoqatat Illyricum, New Age, Dora e Pajtimit & biblioteka Sormani, IPSIA, Acli Lombardia & shtëpia botuese Einaudi, dhe me përkrahjen e Konsullatës së Përgjithshme të Shqipërisë në Milano.

Takimi drejtohet nga Benko Gjata. Dhe përveç shkrimtares do të marrin fjalën edhe Gjon Çoba, konsull i Shqipërisë në Milano, Gianbattista Armelloni, kryetar ACLI Lombardia, Paola Villa, kryetare IPSIA, Silvio Ziliotto nga ACLI/IPSIA, Mirela

**Më 23 shtator në Milano dhe më 24 e 25 shtator në Torino, shkrimtarja Elvira Dones do të takojë publikun për të folur rreth romanit të saj të fundit**



Gjyshja, kryetare e shoqatës Illyricum e Vasenka Rangu nga qendra e Kulturës shqiptare.

Dones do të ketë edhe dy takime të tjera në Torino. Të shtunën më 24 shtator në orën 17.30 dhe të dielën më 25 shtator në orën 20.30 në bibliotekën Italo Calvino (Lungo Dora Agrigento, 94). Edhe takimet e Torinos organizohen Qendra e Kulturës shqiptare në bashkëpunim me shoqatën Vatra, Bibliotekat

e qytetit të Torinos, IPSIA, Acli Torino dhe shtëpia botuese Einaudi, me përkrahjen e Konsullatës së Përgjithshme të Shqipërisë në Milano dhe të Federatës së Shoqatave shqiptare italo-shqiptare dhe arbëreshe të Piemontes.

Edhe këto takime do të drejtohen nga Benko Gjata dhe do të shoqërohen me muzikë nga Lindita Koplaku (pianoforte) e Diana Subashi (violinë).

# TIM CARD ALBANIA LIMITED.

Me **6** cent/min flet me të gjithë numrat në Itali dhe numrat fiks në Shqipëri.



Dhe flet me celularët në Shqipëri vetëm me 9 cent/min. Hyr në TIM duke mbajtur numrin tend dhe dyfisho rimbushjet për një vit.

IMPULS NË PËRGJIGJE 16 CENT DHE TARIFIM ME IMPULSE PREJ 30 SEKONDASH.

TELEFONO NË 119, QË SOT EDHE NË GJUHËN TËNDE. OSE HYR NË DYQANET TIM.

Tarifa 6 cent/min është e vlefshme deri në 1000 min çdo 30 ditë për thirrjet drejt Shqipërisë, për thirrjet në drejtim të operatorëve të tjerë celularë vlen për një maksimum prej 200 minutash në javë. Për info mbi kostot pasi të tejkalohe ky limit hyr në [www.tim.it](http://www.tim.it). Oferta promovionale "dyfishimi i rimbushjeve" është e vlefshme për ata që kalojnë nga operatorë të tjerë në TIM deri në 04/09/2011. Parashikon një bonus maksimal prej 50€ çdo 30 ditë.





# Çelësi i artë i suksesit të MILOTT

Herën e parë që kam parë një ekspozitë të Alfred Mirashit e kam të ngulitur në kujtesë megjithëse kanë kaluar vite. Ishte një mbrëmje dhjetori me shi. Errësira dhe lagështia u shkrinë papritur duke u fshehur në ndonjë cep të humbur të hapësirës sapo hapa derën e sallës. Ngjyrat e telajove të Alfredit më mbështollën me një përqaftim të ngrohtë e rrezatues. Ashtu si buzëqeshja e artistit që në vitet e mëpasshme do të gjeja në shumë ekspozita e aktivitete, në katalogë arti e nisma të komunitetit shqiptar në Itali.

Alfred Mirashi, ose Milot siç njihet në mjediset e artit, është një prej mijëra shqiptarëve të ardhur në Itali me eksodin. E ndërsa në forma nga më të ndryshmet këtë vit përkujtohet 20 vjetori i kësaj ngjarjeje, një skulpturë e artistit shqiptar është vendosur përpara pallatit të Kinemasë me rastin e festivalit të Filmit, në kuadrin e ekspozitës me titullin Open.

Një mbërritje, po të bëhej fjalë për dikë tjetër. Vetëm një etapë, për Alfredin që nuk ndalet kurrë. Pas Liceut Artistik "Mujo Ulqinaku" në Durrës, ai ka mbaruar Akademinë e Brerës në Milano. Një përzierje shkollash dhe metodash që me sa duket ka pasuruar artistin Milot. Është ai që mbi shtatë vezë gjigante të vendosura nga vinçat në oborrin e Kështjellës Maschio Angioino në Napoli ka pikturuar ikonat e kohës sonë : nga Maradona tek Nënë Tereza, duke kaluar nga Skënderbeu e Dante. Është ai që ciklin "Cepat Mesdhetarë" e ka çuar në vende të ndryshme të botës, duke përcjellë diellin dhe dritën, gjelbërimin dhe kaltërsinë, Mesdheun, por mbi të gjitha Shqipërinë. E mbart në vetvete, jo vetëm në emrin e artit që ka zgjedhur. E mbart në mënyrën se si ecën e si të sheh drejt në sy, si flet me pasion për folklorin apo zakonet, e përçon në tela-jo e skulptura. Kritikët shkruajnë se një prej elementëve më origjinalë të veprave të Alfred Mirashit është një përpunimi individual që ai i ka bërë motiveve shqiptare. Drita që përçojnë është ajo e atdheut, ngjyrat janë ato që ai ka thithur në fëmijërinë e tij e që kanë lënë shenjë të thellë tek artisti.

Me entuziazmin që e karakterizon dhe që e transmeton menjëherë ai na dha këtë intervistë. Në lumin e shkumëzuar të ideve të tij, mbetet në mend shikimi i tij, gjithnjë drejt së nesërme, gjithnjë përpara.

INTERVISTA

**Alfred Mirashi, ose Milot siç njihet në mjediset e artit, është një prej mijëra shqiptarëve të ardhur në Itali me eksodin. E ndërsa në forma nga më të ndryshmet këtë vit përkujtohet 20 vjetori i kësaj ngjarjeje, një skulpturë e artistit shqiptar është vendosur përpara pallatit të Kinemasë me rastin e festivalit të Filmit, në kuadrin e ekspozitës me titullin Open**

**Bota Shqiptare:** Po e fillojmë nga periudha e fundit kohore. Si po shkon artisti Milot? Di që është ende e hapur ekspozita Open në Venecia. Me sa di nuk je ndalur ...

**Alfred Mirashi Milot:** Kritiku italian Paolo De Grandis më ftoi në këtë ekspozitë ndërkombëtare pasi i dërgova projektin e skulpturës. Më pëlqeu shumë ideja e ekspozitës Open, sepse ishte shumë afër, bile mund të them që përputhej me frymën e veprave të mija të kohëve të fundit, të cilat kanë pothuajse të gjitha këtë temë: Open. Kam përdorur idenë e çelësit në si në pikturë ashtu dhe në skulpturë, një simbol të hapjes. Sot që bota po kalon një krizë pothuajse në çdo fushë, jo vetëm në ekonomi por edhe në edhe në fushat e tjera, them se duhet të jemi të hapur me njëri-tjetrin sepse në këtë mënyrë edhe shoqëria e sotme forcohet. Mendoj se kjo është rruga e vetme.

Skulpturën e punova në studion time në Firenze dhe ndoqa idenë që kisha për ta bërë

me përmasa të mëdha sepse kështu sikur doja ta forcoja e të nxirrja më bukur atë që kisha menduar. Problemi doli kur skulptura do nxirrej nga studioja. Mu desha të shemb muret anësore. Nuk kishte asnjë mundësi tjetër. Ishim dhjetë veta që për një orë e gjysmë mezi e nxorëm veprën nga studioja që tani u bë edhe ajo Open nga muret (qesh... "nuk bëj shaka")

**Kishe qenë dhe më parë në Lido të Venecias në kohën e festivalit të Filmit? Besoj se je ndier pak VIP, jo vetëm sepse ishe në Venecia mes yjeve të kinemasë, por edhe sepse nga e gjithë bota kishte vetëm 27 artistë që merrnin pjesë në ekspozitën Open**

Në Venecia pothuajse jam abonuar për të vizituar Bienenale të artit, por ishte hera e parë që shkoja në periudhën e Festivalit të Filmit. Ishin vërtet një atmosferë shumë e veçantë,

Nga Massimo SGROI

# ÇELËSAT E KUJTESËS

**N**ë erën e falsifikimit absolut, të transformimit të pandaluar të sistemit të njohjes dhe imagjinatës, ekziston ende hapësira e bashkëndarjes së ndjesive me hapësirën e thellë njerëzore ku ndodhet ajo që në quajmë kujtesë? A është e tamam e vërtetë që njerëzimi vrapon drejt vdekjes së historisë ose më mirë forma të re e një androidi njerëzor a është i fiksuar më shumë se kurrë në kërkim të kujtimeve të tij?

Alfred Mirashi, Milot, siç quhet vendi nga ai vjen dhe siç njihet në botën e artit, kujton një prej personazheve të Blade Runner. Jo engjëllin flokëverdhë e djallëzor Roy Batty dhe as Pris, kukullën që ngatërrohet me cyber-lodrat. Më shumë kujton Leonin, njeriun android që, edhe pse i ndërgjegjshëm për pavërtetësinë e kujtimeve që i kanë futur artificialisht në tru, rrezikon jetën për të marrë fotografitë e një familjeje që, në të vërtetë, nuk ka qenë kurrë e tija. Çelësa pra për të hapur dhomat e një kujtise aq të rëndësishme sa vlen më shumë se dhe vetë jeta e tij e shkurtër.

Nga ana tjetër Alfredi ka pasur gjithmonë një marrëdhënie vërtetësie me gjërat e tokës së tij; nga ngjyrat e pëlhurave të ndritshme tipike të Ballkanit tek format e statujave klasike të vendosura në peizazhet nomade të historisë së vet. Shqiptar që, i detyruar nga rrethanat, ka braktisur tokën e tij, një tokë që e mbart me vete në emër, në zemër dhe, rrjedhimisht, në artin e tij.

Ka një lloj të caktuar arti që ndjek më mënyrë gati maniakale eliminimin e përkatësisë në kërkim të një globaliteti që i shërben më shumë tregut se sa kërkimit të vërtetë artistik. E vërteta gjendet, pavarësisht rregullave të ngurta të sistemit të artit, në botën e të panjohurve dhe në mundësinë që ka artisti për të zbuluar herë pas here fytyrën e perëndeshës greke të kujtesës. Dhe, si Uliksi, Miloti përprihet nga udhëtimi; një braktisje e vetëdijshme e vizioneve në një zonë, Mesdheu, që për botën perëndimore është në vetvete sinonim i kujtesës.

Sinteza formale, përtej një shkëlqimi kromatik absolutisht në përputhje me projektin e Alfredit, është arkaik dhe jo-bashkëkohore njëherësh. Ai lexon vendet e kujtesës duke përdorur pamjet dhe ngjyrat që sedimento-

jnë, shekuj pas shekujsh, deri sa bëhen ekrane të shndritshëm të kohës digjitale. (...) Për vetë natyrën e tij, për historinë e tij personale dhe përkatësinë në një popull që

tori, gjë që e ka bërë ky që është: perëndimor, mesdhetar, shqiptar. Çelësat hapin dyert; kalimet që lidhin kujtimin dhe historinë me kohën tonë, fryt i një sedimentimi

dëshmi identiteti, i një udhë-tari të kohës dhe hapësirës që shpaloset nëpërmjet kërkimit gati kompulsiv të mundësisë për të ndarë një kujtim me të tjerët. Alfredi, pikërisht ai, i



”

Alfredi është shumë i drejtpërdrejtë, i qartë në sintezën formale të mendimit të vet. Veprat e tij të fundit janë në të vërtetë një hap themelor në hulumtimin e Milotit. Hulumtim që bën të përkojë projektin artistik me nevojën për ta bërë universal udhëtimin e vet personal në histori, gjë që e ka bërë ky që është: perëndimor, mesdhetar, shqiptar

ka si karakteristikë të qenit konkret, Alfredi është shumë i drejtpërdrejtë, i qartë në sintezën formale të mendimit të vet. Veprat e tij të fundit janë në të vërtetë një hap themelor në hulumtimin e Milotit. Hulumtim që bën të përkojë projektin artistik me nevojën për ta bërë universal udhëtimin e vet personal në his-

mijërvajçar i cili, përtej teknologjive të ndryshme, mbetet i njëlojtë në kuptimet filozofike me atë të dy mijë vjetëve më parë. Sokrati, Fidia, Platoni, Atena, Venusi, por edhe mitologjia dhe transferimi i saj në skulpturë. Maradona dhe Nënë Tereza e Kalkutës, Caravaggio, Aleksandri i Madh, Dante Alighieri, Giordano Bruno, e për të përfunduar me heroin kombëtar të vendit të tij Skënderbeun, janë të përfaqësuar në sipërfaqe kanavace, mbi tekstile që shoqërojnë traditën e Ballkanit për t'u kthyer secili në një aksiomë e servirë në tabakanë e ekzistencës dhe që një çelës i harruar mund të hapë.

Është shembulli absolut i idesë së Alfred Mirashit, më shumë se vezët-skulptura të mëdha të paraqitura në Maschia Angioino. Është mbledhja e mundësive të pafund për të hapur dyer sekrete të kujtesës; hapje që me kalimin e kohës, po bëhen gjithnjë e më të paarrtshme për gjeneratat e reja. Miloti "tradhton", për një herë, hulumtimin e tij personal artistik që e çon në mbivendosjen e pikurës abstrakte me ikonologjinë figurative. Është kjo vepër, sinteza ekstreme e projektit të tij, jço

ardhur nga një popull dhe një vend që kanë pasur një histori nga më të dhunshmet në Evropë, jep një mesazh paqej. Çelësat që nuk përdoren më përfaqësojnë mundësinë e hapjes së gjërave, të realitetit, të hapësirave të ballafaqimit dhe mundësitë e më shumë ngushtohen e harrohen. Objektet, të mbledhura në të gjithë botën, gjatë udhëtimeve të Milotit (në Spanjë, Shqipëri, Itali, Kurdistan, Shtetet e Bashkuara, Turqi e shumë vende të tjera) nuk kanë një specifikë gjeografike, ato janë më tepër një konstante universale. Në thjeshtësinë e tyre në dukje, janë simbolikisht dhe menjëherë një britmë alarmi e artistit shqiptar. Një mijë pjata të shtruara në një qilim të kuq, një mijë çelësa të harruar, të kujtojnë se, siç thoshte Egon Schiele, përpara se të jemi artistë, ose çdo gjë tjetër, jemi njerëz. "Mbetemi Njerëzorë", atëherë; t'i përdorim çelësat e vënë në tabakanë e ekzistencës sonë për të hapur dyert e asaj çka kemi harruar. "Revolucioni" nuk mund të shtyhet për nesër, sipas Alfred Mirashit, Revolucioni nuk pret më gjatë. Është për sot!

Massimo Sgroi, kritik arti

## INTERVISTA

vijon nga faqja 9

një ambient fantastik; ndodheshin atje pothuajse të gjithë aktorët e Hollivudit.

Unë isha me familjen time dhe natyrisht që për mua ishte diçka e madhe, mbi të gjitha sepse po ekspozoja skulpturën time mes artistëve nga shumë vende të botës.

**Jam shumë kureshtarë të di si të ka lindur ideja e çelësave. Është vërtet banale të pyesësh një artist se "si i lind një ide", por mua vërtet më tërheqin çelësat e tu.**

Pothuajse krejt rastësisht. Edhe unë kam pasionin e çelësave, koleksionoj çelësa të vjetër. Është një pasion që e njohin edhe shokët e të afërmit e kur shkojnë diku për pushime a punë, kujtohen të më sjellin ndonjë çelës të vjetër.

Një ditë po rrija një copë të vogël hekuri në studio se më duhej për një skulpturë. Djali im i vogël, Gerardi, për të më imituar, kishte marrë një nga çelësat e koleksionit tim e po i binte me çekiç. "Babi, jam duke e rregulluar çelësin e prishur" më tha. U habita; çelësi kishte marrë një formë më të bukur në këtë mënyrë. Kështu lindi ideja e skulpturës që çova në Venecia.

**Nuk di pse por sa herë që shoh një pikurë tërënde, më duket sikur ngjall një lloj nostalgjie, e gëzuar ama, pa aspak trishtim. Ngjyrat e tablove të tua nuk kanë kurrë hije, errësirë. Si shpjegohet një artist i tillë në një vend ballkanik si Shqipëria, ku nuk di a e mban mend thënieën: "edhe toka është e ngopur me gjak".**

Më vjen mirë që pikurat e mija të transmetojnë këtë ndjesi. Historia e popujve ballkanikë është pothuajse e ngjashme. Mendoj se ne shqiptarët jemi një komb i çuditshëm: me gjenialitet në çdo fushë. Ja për shembull, në Itali, në çdo lloj profesioni, mjekësi, art, sport, muzikë, literaturë e ku di unë, gjen shqiptarë që ia kanë dalë. Them se njeriu sot duhet të shikojë përpara me optimizëm. Edhe ne duhet të marrim nga kultura jonë e mrekullueshme gjërat më të bukura. Kështu mund t'i tregojmë vetvetes në radhë të parë e të tjerëve më pas se vendi ynë është edhe konstruktiv. Mendoj se nga vua-



# Çelësi i artë i suksesit të MILOTT

jtjet e mëdha të një kombi lindin edhe gjërat pozitive. Ose e thënë ndryshe: ka në jetë dhe ditë me shi, por dielli është më i fortë dhe ai natyrën e bën plot me ngjyra.

**Ka ndikuar në këtë fëmijëria jote? Nga ç'familje vjen Miloti, ai që një kritik e përcakton si "perëndimor, mesdhetar, shqiptar".**

Unë, si shumë bashkatdhetarët e mi që tani ndodhen jashtë Shqipërisë, ika nga sistemi totalitar. Familja ime është një familje e thjeshtë malësorësh, me tradita tipike e të ndershme shqiptare. Në kohën e komunizmit ishim të etiketuar si kulakë sepse gjyshi im kishte pasur tokë e bagëti. Fëmijërinë e kam kaluar në Milot, natyrisht vite të kaluara mes vështirësive. Por në mendjen time kanë mbetur gjërat e bukura: ngjyrat që unë përdor në telajt e mia janë fryt i kësaj kujtese. Për shembull, mjafton të përmend fantazinë dhe

ngjyrat, kompozimet e thjeshta të jelekëve e xhamadanëve të qëndisura nga nënat tona.

Identiteti ynë mesdhetar është shumë i fortë në historinë e artit botëror. E them se në radhë të parë artisti duhet ta gjejë personalitetin e tij në art, të besojë në idetë e tij dhe kur të prezantohet të mos i ngjaj askujt. Më pas kritikët dhe artdashësit krijojnë idetë e tyre duke vlerësuar individualitetin e stilit artistik.

**Tanimë veprat e tua kanë arritur një kuotim të lartë, nëse tregu mund të jetë një tregues për artistin. E për këtë nuk kemi si të mos jemi të lumtur dhe krenarë të gjithë. Ke ndonjë plan për të ekspozuar në Shqipëri?**

Pas shumë vitesh plot me sakrificë, dalëngadalë dhe pas ekspozimeve të shumta, një ditë dëshirat fillojnë e realizohen siç duket...

Në Shqipëri do të vije dhe një ditë që të bëj ndonjë ekspozitë. Unë natyrisht jam i gatshëm. Por nuk mjafton vetëm gatishmëria ime. Për organizimin e një ekspozite janë të shumta elementet e nevojshme dhe duhen bashkuar të gjithë.

**Ke vuajtur shumë në fillim, kur ke ardhur në Itali. E di që nuk ke shumë dëshirë t'i përmendësh ato kohë sepse realisht tanimë janë larg si në vite ashtu dhe në jetën tënde besoj. Apo ato fillime të kanë lënë shenjë?**

Besoj se të gjithë shqiptarët kanë vuajtur shumë në fillim, por ato vuajtje nuk duhen harruar, janë ato që na kanë forcuar më shumë, na kanë shtyrë të kërkojmë diçka pozitive në jetë. Të jetosh një jetë normale është e vështirë sot, imagjino të jetosh me art e sidomos në këtë periudhë ekonomike jo bindëse. Duhet të shikojmë përpara dhe me shumë guxim e vullnet të krijojmë një të ardhme të mirë.

**Tani ke krijuar familjen tënde, ke një djalë të vogël. Cili do të ishte urimi yt për të? Çfarë çelësi do të deshe të kishte për të hapur dyert e jetës, ato dyer që ti besoj nuk i ke gjetur gjithnjë të hapura**


Unë, bashkëshortja Albina Shkreli dhe djali 4 vjeçar,



Gerardi, kemi vendosur të jetojmë tani për tani në Firenze, ndoshta qyteti më i bukur në botë, e jo vetëm për një artist. Të jetosh në këtë qytet është diçka e mahnitshme, s'ka rrugë ku të mos ketë një teatër, s'ka shesh pa skulptura e monumente, plot me muze të çdo lloji: arti, shkence. Këtu vijnë për studime njerëz nga gjithë bota. Është qyteti i Giotto, Caravaggio, Leonardo, Dante, Galilei, Arnolfo di Cambio, Brunelleschi. Gerardi përritet këtu, mes kësaj kulture të madhe. Por shpresojmë që ai t'i hapë dyert që dëshiron vetë e të zgjedhë profesionin ku ai të mund të shprehet dhe të jetë i lumtur profesionalisht.

Meqenëse ra fjala tek e ardhmja e Gerardit. Unë jam shumë tifoz i skuadrës Fiorentina. Bashkë me mikun tim Kodhel Rusta marrim të dy djemtë e sa herë që luan Fiorentina këtu jemi në tribunë. Ndoshta Gerardi me djalin e mikut tim do të luajnë një ditë në fushën e atij stadiumi. Shpresoj... Por shpresojmë gjithsesi që ai t'i hapë dyert që dëshiron vetë e të zgjedhë profesionin ku të mund të shprehet dhe të jetë i lumtur profesionalisht.

Irida Cami



Në foto, disa nga punimet e Milott. Në faqen e parë vepra me të cilën mori pjesë në Open në Venecia. Në të djathtë me familjen



Të jetosh në Firenze është diçka e mahnitshme, s'ka rrugë ku të mos ketë një teatër, s'ka shesh pa skulptura e monumente, plot me muze të çdo lloji: arti, shkence. Këtu vijnë për studime njerëz nga gjithë bota. Është qyteti i Giotto, Caravaggio, Leonardo, Dante, Galilei, Arnolfo di Cambio, Brunelleschi. Im bir po rritet këtu, mes kësaj kulture të madhe. Por shpresojmë që ai t'i hapë dyert që dëshiron vetë e të zgjedhë profesionin ku ai të mund të shprehet dhe të jetë i lumtur

## faqet internet të emigracionit

Çdo ditë lajme, hulumtime dhe informacione të dobishme për të gjithë të huajt në Itali.



## Xhufi: "Nëse Topalli do të kish lexuar raportet e ambasadës, do të refuzonte takimin me Pivettin"

**N**ë një intervistë për të përditshmen Shekulli lidhur me kabllogramet e Ambasadës Amerikane në Tiranë (të botuara së fundi nga Wikileaks) ish ambasadori në Romë, Pëllumb Xhufi, thotë se kabllogramet mes ambasadave dhe qeverive përkatëse hyjnë në punën rutinë të stafit diplomatik. Por shpjegon se kabllogramet nuk janë veçse maja e ajsgbergut: "Gjithsesi, mos të harrojmë se jemi në nivelin e kabllogrameve me një nivel sekretimi modest. Imagjinoni se ç'mund të thuhet në informacionet "top sekret" që Ambasada e SHBA, ashtu si çdo ambasadë tjetër, i dërgon në qendër me "valixhe diplomatike", ashtu si në fillimet e artit të diplomacisë"

Por informacionet që ambasadat shqiptare i dërgojnë qendrës, sipas Xhufit nuk vlerësohen siç duhet nga qeveria shqiptare. Kështu për shembull, duke komentuar pritjen e ngrohtë që iu bë ish kryetares së Dhomës së Deputetëve, Irene Pivetti në Shqipëri. "Sikur zonja Topalli të kishte lexuar raportet e ambasadorëve shqiptarë në Romë, në vitet 1991-1992, ajo do të kishte gjetur arsye të bollshme për ta refuzuar qoftë edhe me elegancë takimin e saj me zonjën Irene Pivetti, ish-kryetare e Parlamentit italian në ato vite. Do kishte bërë diçka të ngjashme me atë që bëri ajo gruaja shpirtërrë nga Vlora e shoqatës së viktimave të Otrantos, e cila refuzoi t'i zgjasë dorën e t'i urojë mirëseardhjen ish-kryeparlamentares italiane, përfaqësuese e partisë racizmo-ksenofobe "Lega Nord", e cila në qershor 1991 bënte thirrje publike për t'i mbytur në det e për t'i goditur me top anijet me refugjatë nga Shqipëria. Në rolin e kryetares së Parlamentit italian, zonja Pivetti na ka bërë gjëmën. Zonja Topalli duhet ta kuptojë se për ne shqiptarët ky është profili publik i zonjës Pivetti, dhe jo ai i moderatores së emisionit televiziv "Bisturi", që kjo drejtoi për disa vjet pas largimit nga politika, dhe ku bëhej fjalë, siç kuptohet, për "ribërje" gjoksi, buzësh e të ndenjash".

Po ashtu, ish ambasadori shqiptar në Romë, Xhufi, shpreh shqetësim për marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Greqisë: "mund ta quanim të paqme punën e një ambasade shqiptare, le të marrim si shembull atë të Athinës, në rast se me zgjedhjen e z. Samaras si kryetar i Partisë "Nea Demokracia", këtu e dy vjet më parë, kjo ambasadë mos ta informonte Ministrinë e saj të Jashtëme në Tiranë mbi të kaluarën politike të z. Samaras, mbi precedentet negativë të tij në marrëdhëniet me Shqipërinë e me vende të tjera të rajonit në kohën kur ishte ministër i Jashtëm i Greqisë, e më vonë drejtues i një partie me prijje ekstreme nacionaliste, mbi mbështetjet, miqësitë e deri mbi dobësitë e tij eventuale njerëzore. Z. Samaras nesër do jetë me siguri kryeministri i Greqisë, dhe homologu i tij shqiptar, Berisha apo Berishçka e radhës, duhet ta dijë se nuk ka të bëjë me një engjëll të virgjër, që i ka për "sefte" punët me Shqipërinë. Nëse z. Basha, si ish-ministër i Jashtëm, do të kishte hapur dosjet me raportet e ambasadorëve tanë në Athinë, ato të viteve 1990, do të kishte kuptuar se zonja Bakojanis erdhi në Tiranë në vitin 2008 jo thjesht për t'u puthur me të, por për të realizuar disa porosi që ia ka lënë amanet babai i

saj, ish-kryeministri Micotaqis, dhe për të cilat ambasadorët e Shqipërisë në Athinë kanë përcjellë atë kohë informacione të bollshme".

Ai flet në veçanti edhe për kabllogramet lidhur me "ujdinë e pistë të detit", siç e quan ai. "Ka një detaj të zbuluar nga kabllogramet e Ambasadës së SHBA në Tiranë, dhe për të cilat asnjë "pasqyrë e shtypit shqiptar" nuk ka bërë fjalë. I referohem ujdisë së pistë të qeverisë shqiptare me qeverinë greke, për ta mbajtur marrëveshjen e kufirit detar të fshehur jo vetëm nga opinioni shqiptar, por edhe nga SHBA, e cila nuk duhet të vihej në dijeni për sa do të diskutohej e do të vendosej mes dy mëkatarëve".

Dhe vazhdon më tej: "ShBA i kanë bërë thirrje të përsëritura klasës politike shqiptare, që të marrë një "qasje patriotike" në ushtrimin e misionit të saj. Tashmë gjithkush e di që kjo e fundit ka bërë pikërisht të kundërtën. Përveçse ka vënë në pikëpyetje serioze prioritetin e integritetit, qeveria aktuale, në radhë të parë, ka arritur të shesë interesa kombëtare. Marrëveshja e turpshme e detit me Greqinë çon më tej veprën mizore të armiqve historikë të Shqipërisë, të cilët kanë dashur gjithnjë asgjësimin, apo më së paku, copëtimin e reduktimin e territorit e të kombit shqiptar. Me realizimin e regjistrimit të pasurive e të popullsisë, sipas matricës së ardhur nga Athina, qeveria Berisha po hedh një hap të rrezikshëm drejt kthimit të pamerituar të vendit tonë në një vend "multietnik", drejt ringjalljes së risentimenteve me bazë etnike e fetare, me synim final libanizimin e Shqipërisë. Deri tani, pushtetarët janë munduar ta nanurisin opinionin publik, duke i paraqitur si marrëveshjen për ndarjen e detit me Greqinë, ashtu edhe regjistrimin me deklarim të besimit dhe vetëpërcaktim të kombësisë, si "detyrime" që rrjedhin nga procesi i integritetit në BE e në NATO, apo si "standarde" të aplikuara nga gjithë demokracitë moderne. Është pikërisht e kundërta: marrëveshjet e regjistrimit në fjalë bien ndesh me vlerat e standardet evropiane si dhe me ligjin kombëtar dhe atë ndër-kombëtar, dhe mu për këtë arsye kanë shqetësuar partnerët tanë, të cilët shohin qartë tek lëshimet e paprincipita të politikanëve të korruptuar shqiptarë farët e armiqësive e konflikteve të ardhshme në Shqipëri e në Ballkan. Këtu e ka bazën, mendoj unë, edhe shqetësimi i shprehur nga kabllogramet amerikane lidhur me dy "xhevahiret" e fundit të qeverisë Berisha".

ShBA i kanë bërë thirrje të përsëritura klasës politike shqiptare, që të marrë një "qasje patriotike" në ushtrimin e misionit të saj. Kjo e fundit ka bërë pikërisht të kundërtën. Përveçse ka vënë në pikëpyetje serioze prioritetin e integritetit, qeveria aktuale, në radhë të parë, ka arritur të shesë interesa kombëtare

**K**ush tha që plazhi është vetëm për njerëzit? Buzë detit, poshtë çadrave, mbi shezlong, në shtrat, rrinë e lëvizin edhe kafshë. Nga të gjitha llojet. Shtëpiake ose të egra.

Normalisht plazhi përshoqërohet me njeriun, meqë vetëm ky e sheh si mjet pushimi. Kafshët mund ta përdorin për t'u ushqyer, por jo për t'u relaksuar. Vetë njerëzit, kur shkojnë në plazh, presin që të shohin kryesisht njerëz. Por jo në plazhet shqiptare.

Këtu nuk është fjala për miqtë më të mirë të njerëzve: qentë. Këta të fundit



rrinë në plazh se shoqërojnë padronët e tyre, jo sepse kanë vendosur ta kalojnë pesëmbëdhjetëditëshin pranë detit. Megjithatë, prania e tyre nëpër çadra e në breg tolerohet në bazë të shtatmadhësisë. Po të jetë chihuahua, ose të ndonjë racë tjetër e vogël, ka gjasa që të bëhet maskota e plazhit; fëmijët pyesin për emrin, e thërrasin, pastaj e ledhatojnë, fillimisht me frikë pastaj më me guxim; të rriturit i fërkojnë kokën, bëjnë ndonjë pyetje më specifike, ose rrinë indiferentë.

Po të jetë qen i madh, për shembull qen kufiri, ose bulldog, gjërat ndryshojnë. Prindërit ia shtrëngojnë fort dorën fëmijës, instinktivisht, shikojnë gjithë frikë nga qeni, japin këshilla për kujdes. Padronët fillojnë e qetësojnë komshin-

Pa prituri pa kujtuar, të shfaqet në buzë të ujit një kafshë e madhe. Duket si lodër plush, nga ato gjigandet. Ecën, lëviz, lëkundet: me siguri është qenie e gjallë. Në të vërtetë është arushë.

E vogël në moshë. E tërheq i zoti (?) me një zinxhir që i kap mizorisht hundën. Gruaja me aparat fotografik në dorë bën fotografi të çastit. 500 lekë copa. Kush tha që në plazh ka kafshë vetëm të gjalla? Ka edhe të vdekura, madje të balsamosura. Ç'bën në rërën e detit shqiponja e balsamosur? Po nusja e lalës? Është dhëlpër ajo? Galeria nuk përfundon lehtë, duket si muzeum zoologjik por ku mund të blesh kafshët e mbushura me kashtë. 13.000 një shqiponjë

jtë e çadrës për natyrën e urtë të qenit të vet. Ftojnë për ledhatime kolektive, pa respektuar dëshirën e mikut, të qenit e të komshiu bashkë. "Nuk të bën gjë! Preke, këtu te koka! Nuk të kafshon, është i mirë!". Ti heziton, sepse e shikon me llapën përjashta të heshitur. E meqë qeni që leh nuk të ha, del që... Padronët

# KAFSHË NË PLAZH



duken më të efektshëm po të kenë fëmijë të vegjël. "Janë mësuar me fëmijët". "Dakord, por me të tutë..."

Mirëpo plazhi shqiptar është i pasur me kafshë të tjera. Aspak ujore. Pa pritur pa kujtuar, të shfaqet në buzë të ujit një kafshë e madhe. Duket si lodër plush, nga ato gjigandet. Një tufë e madhe me lesh të murrmë. Ecën, lëviz, lëkundet: me siguri është qenie e gjallë. Shoqërohet nga një grup fëmijësh zhurmëshumë. Problemi është se truri nuk ta pranon që në breg të detit të ketë arinj. Je mësuar t'i shohësh në kopshin zoologjik, ose në biopark siç

thonë politikisht korrektët, ndonjëherë në cirk, por asnjëherë në plazh. Nuk është në habitatin e vet, as në atë artificial.

Në të vërtetë është arushë. E vogël në moshë. E tërheq i zoti (?) me një zinxhir që i kap mizorisht hundën. Gruaja me aparat fotografik në dorë bën fotografi të çastit. 500 lekë copa. Arusha ankohet herë pas here. Plazhistët qeshin e admirojnë, si zogun kur këndon në kafaz prej marazit. I zoti nuk lejon askënd ta prekë, shenjë që ka frikë se mos kafsha reagon. E tërheq fort me zinxhirin tek hunda në çastin

kur merret poza. Plazhisti gjysmë lakuriq krekoset me dorën tek pelicja gjithë lesh e buzëqesh si idiot. Kujton se është me bashkëshorten, diku aty afër, një balenë e skuqur me dy këmbë. Arusha dihat, mezi merr frymë, duket nervoze.

Marr guximin e shkoj të bëj disa pyetje. Sa kushton? Është mashkull apo femër? Më jepen përgjigje automatike, sa për të larë gojën, ndërsa arusha detyrohet të marrë poza me njerëz në plazh. E shoh që vuan. Është kohë dreke, dielli të përcëllon. Atëherë pyes nëse vuan nga vapa. "Natyrisht që vuan,

Në plazhet shqiptare gjen edhe kafshë buzë detit. Dhe jo vetëm qen e mace, por edhe arinj e shqiponja, të gjalla apo të balsamosura. Jemi njerëz kaq të emancipuar, sa respektojmë të drejtat e kafshëve? Jo gjithnjë. Shpesh janë edhe burim fitimesh. Të gjorat kafshë!

më përgjigjet fotografja. Nuk e duron vapën". Mirëpo, këtë e dinë të gjithë. Edhe fëmijët që shkojnë në kopsht zoologjik nuk habiten kur i shohin arinj të tek hanë copa akulli për t'u freskuar. Janë kafshë që jetojnë larg detit, larg rërës, në freski. "Mundohemi ta freskojmë herë pas here", shton gruaja me ton justifikues, gati duke e deklaruar gënjeshtren. Pastaj vijon me fjalinë sa enigmatike aq edhe fatale "Po s'kemi ç'bëjmë". Dikush i jep 1000 lekë për dy poza të porsabëra. Ja, ky ekzibicionist me kostum banjo, që sapo mori dy fotografi, mund të bënte diçka

për shembull. Të mos kapërdisej pranë arushës së përvuajtur. Por paguan si pa të keq, duke admiruar fotografinë polaroid. E ndjen veten gjuetar të ekzotikes, pjesë të një përvoje të paparë.

Arusha tërhiqet zvarrë nga hunda e humbet në mizërinë e plazhit. Nuk kalojnë disa minuta e kalon një gjarpër që përdridhet në duart e një zbutësi të improvizuar. Edhe ai i shoqëruar pashmangshmërisht nga fotografi, si dikur mbretërit nga kronistët mesjetarë. Për t'i përjetësuar bëmat. Ka pak aspirantë për të bërë fotografi me gjarpurin. Dikush rreket ta prekë, por nuk lejohet. Ndoshta edhe prekja kushton. Dikush pyet, por e kupton që historia është e pambajtshme: lloj i rrallë, helm vdekjeprurës, shtrëngim mbytës... Gjarpri nuk ka kohë të bëhet xheloz për suksesin e arushës. Përveç frikës që i kall uji i detit, duhet të mbahet si ekuilibrist në krahët e të zotit, i cili e ngre lart për t'ia treguar trofeun gjithë plazhit. Sytë me admirim nuk mungojnë, disa vihen në rresht për "kush bën poza më të bukura". Padroni largohet nga fusha e teleobjektivit, por del gjithsesi në foto. Do të jetë i pranishëm në shumë shtëpi, si zvarranik mes zvarranikëve.

Kush tha që në plazh ka kafshë vetëm të gjalla? Ka edhe të vdekura, madje të balsamosura. Ç'bën në rërën e detit shqiponja e balsamosur? A nuk duhet të ishte maleve? Po nusja e lalës? Është dhel për ajo? Galeria nuk përfundon lehtë, duket si muzeum zoologjik por ku mund të blesh kafshët e mbushura me kashtë. 13.000 një shqiponjë. S'ka gjë, Shqipëria është vend i shqiponjave, vjen nga "shqipe". Ka plot nëpër male, por askush nuk i sheh më. U fshihen gjuetarëve për të mos përfunduar tek plazhistët. Këta i blejnë, por nuk dihet ku i mbajnë. Në dhomën e plazhit, përkohësisht? Çfarë historirash u tregojnë miqve kur u vijnë për vizitë? Isha në bjeshkë, kur pashë nga larg një shqiponjë, mora mauzerin...

Një fëmijë i vogël bën pyetjen më fëmijërore. A lejohen kafshët në plazh? Të gjithë përreth ngrënë supët e djegura nga dielli. Jo për përgjigjen, për pyetjen "e çuditshme". Dikush i gëlqerosur me krem të bardhë kundër diellit, kinse me mendje më të freskët, mundohet t'i japë justifikim me baza juridike. Do e ketë bërë natën. Dorëzohet kur dikush tjetër i kujton se përveç mirëqënies së kafshëve, pra respektimit të tyre, meqë janë qenie të gjalla edhe ato, ekziston edhe çështja e sigurisë, e higjienës, e shëndetit të njerëzve. Pastaj është problemi i mbrojtjes së disa llojeve që rrezikojnë të shuhen. Kthehet nga ana tjetër kur i zë veshi fjalën qytetari.

Është çasti që fëmija të bëjë pyetjen tjetër: "Kush janë kafshët në plazh?"

Fotografitë janë të Pishak Zhgabës  
xhaxhai.wordpress.com

## BANKA E SHQIPËRISË

### Shqipëria deficitare 45 milionë euro në turizëm

Për herë të parë këtë vit në bilancin e gjashtëmuorit të parë Shqipëria del deficitare në bilancin e hyrje-daljeve të vlerave monetare me qëllim turizmin

Sipas të dhënave zyrtare nga Banka e Shqipërisë, mësohet se në gjashtëmuorin e parë të vitit kanë hyrë në ekonominë vendase 415 milionë euro, ndërsa shqiptarët kanë shpenzuar për vizita dhe pushime jashtë, po gjatë kësaj periudhe, plot 570 milionë euro. Humbjet për ekonominë vendase janë plot 45 milionë euro për gjashtë muaj, duke e vënë Shqipërinë për herë të parë gjatë periudhës së tranzicionit përballë këtij fenomeni.

Ekspertët në Bankën e Shqipërisë, por edhe jashtë saj, e kishin lajmëruar këtë situatë. Liberalizimi i vizave mësohet të ketë patur efektet themelore në daljen e vlerave monetare jashtë vendit. Në janar të këtij viti qytetarët shqiptarë nisën të lëvizin pa viza në vendet e BE. Duke qenë se edhe numri i shqiptarëve që jetojnë në këto shtete është shumë i madh, udhëtimet nga Shqipëria jashtë kanë qenë më të dendura këtë vit, duke rritur kështu edhe daljet e vlerave monetare jashtë. Ky bilanc negativ në udhëtime ndikon negativisht në ekonominë

vendase, në një kohë kur edhe zëra të tjerë që sjellin të ardhura në vendin tonë po shterojnë.

Të dhënat zyrtare të Bankës së Shqipërisë treguan se për gjysmën e parë të këtij viti dërgesat e emigrantëve kishin vlerën e 342 milionë eurove. Krahasuar me gjysmën e parë të vitit 2010, remitancat kanë rënë me 12%, ndërsa krahasuar me gjysmën e parë të vitit 2009, rënia është 19%. Këto të dhëna dëshmojnë se fenomeni i rënies së remitancave po fiton vazhdimësi dhe është tashmë në një tendencë në ekonominë tonë. Në fakt, kjo rënie është një fenomen normal dhe që është verifikuar edhe në vendet e tjera që kanë pasur valë të mëdha emigracioni. Me kalimin e viteve, të larguarit e ndërtojnë jetën në vendet ku kanë emigruar dhe lidhjet me vendin e origjinës gradualisht zbehen. Por për Shqipërinë ky cikël ka koiciduar me krizën ekonomike që preku pothuajse të gjithë botën pas vitit 2008.

Gjithashtu, rënie kanë pësuar edhe disa zëra të tjerë të bilancit të pagesave,

sidomos të atyre që lidhen me investimet. Në këtë krahasim vijon të mbetet pozitive rritja e eksporteve, e cila ka sjellë e prurjet më të mëdha valutore në dy vitet e fundit.

Me gjithë problematikat e momentit, eksportet dhe turizmi po shenjohen si dy sektorët të cilët po mbajnë ekonominë shqiptare me para. Ekspertët e Bankës Qendrore madje mendojnë se këto dy sektorë duhet të jenë në qendër të një strategjie të re zhvillimi ekonomik të vendit. Të njëjtat burime pohojnë se bilanci negativ në sektorin e turizmit këtë gjashtëmuor nuk do të jetë një prirje që do të vazhdojë gjatë, për shkak se udhëtimet e shqiptarëve jashtë vendit do të arrijnë shumë shpejt pikën e ngopjes, duke kufizuar në këtë mënyrë edhe daljen e eurove jashtë vendit. Ndërkohë që gjithnjë e më tepër Shqipëria po pozicionohet si një vend me atraksione turistike që mund t'i sjellin vendit në të ardhmen një turizëm të qëndrueshëm.

Blerina Hoxha, Mapo

# Banka jote është e gjitha këtu.



## Carta Enjoy. Gjithçka që të nevojitet me vetëm 1€ në muaj!

**Për të pasur gjithçka, pa pasur llogari.**

Enjoy të lehtëson jetën, sepse të jep të gjitha avantazhet e një llogarie rrjedhëse, pa pasur një llogari rrjedhëse. Për të akredituar rrogën, për të blerë në të gjitha dyqanet dhe në internet, për të tërhequr para falas në mbarë Italinë pranë sporteveve ATM dhe jashtë shtetit në qarkun Mastercard, për të ngarkuar celularin, dhe për shumë shërbime të tjera, zgjidh komoditetin. Zgjidh Kartën Enjoy.

Eja menjëherë në UBI Banca! Për të gjetur filialin më të afërt vizito faqet internet [www.ubibanca.com/nuovi-italiani](http://www.ubibanca.com/nuovi-italiani) ose telefono në numrin e gjelbër 800 759 759.

PËR MË TEPËR MUND TË DËRGOSH PARA ME



**UBI Banca**

Mesazh reklamues me qëllime promovimi. Për kushtet e kontratës shiko fletët informuese në të gjitha filialet e Bankave të Grupit UBI Banca.

800.759.759 - [www.ubibanca.com](http://www.ubibanca.com)

**M**ijëra personat e ngjeshur në anijen Vlora, që edhe kur mbushnin sheshin e portit të Barit e vazhdonin të linin plot anijen: imazhi që më mirë se çdo gjë tjetër jep idenë e zbarkimit në masë të shqiptarëve në brigjet e Puglies 20 vjet më parë. Foto që ka hyrë në histori, që edhe sot e kësaj dite të emocionon e të lë gojëhapur.

Profile, lot e buzëqeshje, lodhje dhe ngazëllim, frikë dhe shpresë, të shqiptarëve që 20 vjet më parë u larguan nga Shqipëria mbushën plot e përplot anijen Vlora dhe mbërritën në portin e Barit, ashtu si vetëm pak muaj më parë, mëse 20 mijë të tjerë bënë me anijet që gjetën porteve shqiptare për të mbërritur në Brindisi.

Dhe pikërisht mbërritja e Vlorës në portin e Barit, në orën 8.30 të 8 gushtit 1991 është fiksuar në 50 fotografi bardhezi apo me ngjyra të fotografit dhe kino-operatoorit barez Luca Turi, të mbledhura më 13 shtator në një ekspozitë të organizuar nga komisioni i kulturës së Komunës së Barit në teatrin Petruzelli të kryeqendrës së Puglies.

Iniciativë "për të mos harruar - thotë kryetari i komisionit Filippo Melchiorre - viktimat e shumta të detit, si 190 personat që u mbytën pak ditë më parë në Zanzibar".

Në atë ditë të nxehtë gushti, një masë mbresëlënëse njerëzish vërshoi mbi bankinat e portit të Barit. Ishin refugjatë shqiptarë që largoheshin nga Shqipëria e sapodalë nga regjimi komunist. Të ngjeshur si sardele në bark të Vlorës. Atë ditë, fotoreporteri Luca Turi fiksoi me aparatit e tij një ngjarje që do të mbetet përjetë në histori dhe që pas dy dekadash, Bari kujton me një ekspozitë me titull "Arratia e shqiponjave".

50 panele me foto tregojnë fazat e ndryshme të mbërritjes së shqiptarëve: nga ankorimi i anijes në port, deri tek ndihma e parë të plagosurve e më pas te mbyllja në stadiumin Vittoria të Barit. Fotografitë janë ndarë në katër zona tematike. E para tregon mbërritjen e Vlorës. E dyta mbajtjen e refugjatëve në stadiumin e Barit. E treta u kushtohet fëmijëve të anijes Vlora. Ndërsa e katërta tregon solidaritetin e popullit të Barit, ndihmat që barezët u sollën mijëra të dëshpëruarve.



Foto Luca TURI

## ARRATIA E SHQIPONJAVE Ekspozitë në Bari me fotografitë e Luca Turit të anijes Vlora

Është hapur në Teatrin Petruzelli të Barit ekspozita me 50 fotografi të Luca Turit, të zbarkimit të 20 mijë shqiptarëve të anijes Vlora në Bari

Të shumta konsiderimet për Luca Turin gjatë përrimit të ekspozitës: "fotograf historian i çastit" sipas kritikut të të përditshmes Gazzetta del Mezzogiorno, Patruno, "dëshmitar i solidaritetit të barezëve" për këshilltarin komunal Barattolo.

Në përrimin e ekspozitës edhe komandanti i anijes Vlora, Halim Milaqi, të cilit i është dhënë një pllakë përkujtimore. Ia dorëzoi Anna Delfino, e veja e kryetarit të atëhershëm të komunës së Barit, Enrico Delfino, që ato ditë gushti të 1991-shit u përball me një emergjencë të paparë për qytetin e tij.



Foto Luca TURI

## Rishikim i historisë së Shqipërisë Takim me një vend që po zbulon vetveten

Shoqata italo-shqiptare Occhio Blu organizon prezantimin e librit "Tradizione, nazionalismo e comunismo nell'Albania contemporanea" (Tradita, nacionalizmi dhe komunizmi në Shqipërinë bashkëkohore) të Paolo Rago. Autori, që do të jetë i pranishëm në aktivitetet, jeton prej rreth 20 vjetësh

në Shqipëri. Ai ka punuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Kooperacionit Italian, UNICEF, Banka Botërore etj.

Prezantimi i librit është në program më 23 shtator në orën 18.00 në Sala Gonzaga, Via della Consolazione 4, Romë.

Nën drejtimin e Amb. Mario Bova, do



Më 23 shtator, shoqata Occhio Blu prezanton në Romë librin "Tradizione, nazionalismo e comunismo nell'Albania contemporanea" me autor Paolo Rago

të zhvillohet një debat me pjesëmarrjen edhe të profesorëve Roberto Morozzo della Rocca (Histori e Europës Lindore pranë Universitetit Roma 3, Antonello Biagini (Histori e Europës Lindore pranë Universitetit "La Sapienza") dhe Elio Miracco (Gjuhë dhe Letërsi shqipe pranë Universitetit "La Sapienza")

**M**bi 5 mijë shqiptarë në Itali kanë kërkuar deri tani pasaportën biometrike në një prej dy zyrave të hapura në Itali, pranë konsullatës në Milano apo pranë zyrës konsullore të Ambasadës në Romë. Vetëm në zyrën e konsullore të Romës kanë mbërritur deri më sot mbi 1.900 pasaporta të gatshme. Duke i shtuar kësaj shifre ata që kanë aplikuar javët e fundit, pasaportat e të cilëve ende nuk janë gati, dhe duke pasur parasysh që fluksi në Milano është më i lartë se ai i shqiptarëve që aplikojnë në Romë, është e lehtë të thuhet që deri më sot (nga 27 prilli, datë kur nisi procesi) kanë aplikuar për pasaportë biometrike mbi pesë mijë shqiptarë. Mbi 1.300 vetë në muaj. Apo e thënë ndryshe, nga ky proces shoqërisë Aleat, deri tani i kanë hyrë rreth 550 mijë euro.

Konsullata e përgjithshme e Shqipërisë në Milano, në faqen e saj të internetit, lajmëron se të gjithë qytetarët shqiptarë që kanë aplikuar për pasaportat biometrike pranë konsullatës nga 28 prilli deri më 19 gusht, mund të paraqiten pranë saj për t'i tërhequr". Natyrisht, nëse nuk e kanë bërë deri më sot.

Sipas lajmërimit on-line të Konsullatës, tërheqja bëhet nga ora 12:00 deri në orën 14:00, nga e hëna në të premte, duke paraqitur faturën e aplikimit dhe një dokument identifikimi. Nëse pasaporta mund të tërhiqet edhe nga një familjar (me faturën e aplikimit), kush ka paraqitur kërkesë edhe për letërnjoftimin elektronik, duhet të paraqitet personalisht në

## PYETJE NË REDAKSI

**P**asaporta biometrike, të cilën po nxitojnë të gjithë të fusin në xhep, nuk është dokument i detyrueshëm në shumë raste. Për shembull, një shqiptar që ka letërnjoftimin elektronik, jeton në Shqipëri e nuk dëshiron (apo nuk ka mundësi) të përfitojë nga liberalizimi i vizave - i vlefshëm vetëm përmbajtësit e pasaportës biometrike - mund edhe të mos aplikojë për këtë dokument. Gjithashtu, duhet thënë që asnjë ligj deri më sot nuk ka nxjerrë jashtë përdorimit pasaportat e vjetra. Ato janë të vlefshme deri në datën e skadencës së tyre.

Promovimi që u është bërë pasaportave biometrike, natyrisht ka lënë gjithnjë mënjane këto hollësi, duke këmbëngulur në rëndësinë e marrjes së dokumentit të ri, në sigurinë e lartë të tij, në mundësitë që ai të jep për të lëvizur në zonën Schengen. Asnjëherë nga ministria e Brendshme nuk është sqaruar qartë që gjithsesi ky dokument mund edhe të mos merret.

Çështja bëhet edhe më delikate për emigrantët. Përveç çmimit të lartë që

# PASAPORTAT BIOMETRIKE

## Mbi pesë mijë aplikime në Romë e Milano

Në Konsullatën e përgjithshme të Milanos, mund të tërhiqen pasaportat për të cilat është aplikuar deri më 19 gusht, ndërsa sipas faqes internet të Ambasadës sonë, të përditësuar më 2 shtator, janë mbi 1.900 pasaportat që kanë mbërritur deri tani



## Deri kur vlejnë pasaportat e vjetra?

**Jam emigrante në Itali (me kartë qëndrimi) dhe kam pasaportën e vjetër shqiptare që më skadon në vitin 2017. Dua të di a mund të vazhdoj ta mbaj, apo duhet të aplikoj sa më parë për pasaportën e re biometrike siç më thanë në telefon nga Ambasada?**

duhet të paguajnë (108 euro), duhet të mendojnë edhe për përditësimin e të dhënave në dokumentin e qëndrimit i cili kushton mbi 70 euro të tjerë. Meqë

problemi i "detyrimit" të aplikimit për pasaportën e re është ngritur disa herë nga lexues të shqiptariitalise.com, rreth një muaj më parë telefonuam nga redak-

konsullatë.

Për informacione të ndryshme mund të kontaktoni përmes numrit të celularit +39.3920686139 apo te konsultoni sitin zyrtar të konsullatës së Milanos.

Ndërsa Zyra konsullore e Ambasadës shqiptare në Romë ka përditësuar listën e pasaporta të gatshme, me të reja të mbërritura më 2 shtator 2011. Vetëm në këtë zyrë pasaportat e reja të mbërritura, që janë tërhequr apo mund të tërhiqen nga mbajtësit, janë mbi 1.900.

Këtu, nën këtë artikull gjeni listën e plotë të pasaportave të gatshme të aritura në Ambasadë deri më 2 shtator. Kush gjen emrin në listë e nuk e ka tërhequr ende pasaportën biometrike dhe letërnjoftim elektronik, mund të paraqitet pranë Ambasadës së Shqipërisë në Romë për t'i tërhequr ato në oraret 13:00 - 15:00, nga e hëna deri të premten.

Për tërheqjen duhet të paraqiten me një dokument identiteti me foto dhe me faturën e aplikimit.

Tërheqja e letërnjoftimit bëhet vetëm në praninë e personit që ka aplikuar, ndërsa për fëmijët pasaporta mund të tërhiqet edhe nga prindi, pa praninë e fëmijës duke pasur me vete një dokument që vërteton lidhjen familjare me fëmijën.

Para se të shkohet në Ambasadë është mirë të pyetet në numrin e celularit të vënë në dispozicion për informacione (0039)342.364.0798 apo të konsultohen faqet internet ku botohet lista e pasaportave të gatshme.

ke.bi.

sia në zyrën konsullore të ambasadës sonë në Romë për të parë ç'përgjigje japin. Punonjësja ishte e prerë. Edhe pse i thamë qartë që pasaporta skadon pas disa vjetëve, u përgjigj qartë: "Duhet të aplikoni sa më shpejt pasi me pasaportat e vjetra nuk do të mund të udhëtoni më vitin e ardhshëm".

Për të qenë të sigurt i kërkua ambasadorit një prononcim mbi këtë çështje dhe ai na siguroi që deri më sot nuk ka asnjë ligj që të nxjerrë jashtë qarkullimit pasaportat e vjetra: ato janë të vlefshme deri në skadencën e tyre të natyrshme.

Sot provuam sërish të lidheshim me ambasadën, këtë radhë përgjigja - që mbërriti pas shumë tentativave në celularin e vënë në dispozicion për informacionet mbi pasaportat - nuk ishte e prerë si në gusht. "Nuk kemi informacion të saktë për skadimin e pasaportave të vjetra. Flitet që do të dalin nga qarkullimi në fund të vitit, ndaj është mirë të nxitoni e ta bëni që tani aplikimin për të renë" kështu u përgjigj sot punonjësi.

Keti Biçoku

**ISI RICERCA**  
**HOSTESS E PROMOTER**  
**INTUTTA ITALIA.**

I candidati si occuperanno della promozione vendita dei servizi ISI direttamente nel punto vendita. Si richiede precedente esperienza in attività di vendita, e disponibilità immediata a lavorare sia part time che full time, che nel fine settimana. Completano il profilo dinamicità, flessibilità e forte predisposizione alla vendita nonché massima serietà e disponibilità.

Se interessati mandare curriculum con foto a:  
e-mail: [customerservice@isi.eu.com](mailto:customerservice@isi.eu.com)  
oppure telefonare orario ufficio ai numeri  
06 87410555 - 06 87410412

## AGENZIA DI CONSULENZA E SERVIZI EJONA



Ejona, è l'agenzia di consulenza, nata a Milano, con la missione di facilitare e accompagnare nella strada dell'integrazione, con professionalità e umanità i propri clienti, studenti e cittadini albanesi, residenti in Italia nel disbrigo delle pratiche burocratiche e questioni legali. Inoltre, anni di conoscenza del territorio e di quel che offre la regione Lombardia, consentono di offrire le soluzioni migliori a tutti i connazionali che vorranno viaggiare in Italia, per affari, turismo, eventi, shopping ecc.

Web: [www.ejona.eu](http://www.ejona.eu) - Email: [info@ejona.eu](mailto:info@ejona.eu)

Tel: +39 388 6908991 - Skype: [ejona.milano](https://www.skype.com/name/ejona.milano) - Facebook: [Ejona Milano](https://www.facebook.com/EjonaMilano)

## Në mjekësi pranohen vetëm 50 nga 2000 studentë të huaj

**Apel i Shoqatës së mjekëve me origjinë të huaj pas testit të pranimit: "Këta të rinj po harxhojnë gjithë ç'kanë për të qëndruar në Itali, a ka ndonjë shpresë të zënë vendet që janë bosh?"**

**D**o të jetë për faj të gjuhës apo për çështje të tjera tepër "lokale": një gjë është e sigurt, testet e pranimit të fakultetit të Mjekësisë kanë "masakruar" të rinjtë e huaj që dëshironin të ndiqnin këtë degë. Duket se kanë kapërcyer testin vetëm 50 ndër 2000 pjesëmarrës të huaj në to. E tani, sa prej tyre do të kthehen vërtet në vendlindje?

Foad Aodi, kryetar i Shoqatës së mjekëve me origjinë të huaj në Itali (AMSI) dhe i Komunitetit të arabëve në Itali (Comai), i preokupuar thotë: "Janë shumë pak të rinjtë me dëshirën për t'u bërë mjekë që kanë kaluar provimin e pranimit. Flitet vetëm për 50 vetë nga 2.000 që kanë provuar".

Amsi fajëson "vështirësitë gjuhësore", por në të vërtetë të rinjtë e huaj japin më parë një provim gjuhe për t'u regjistruar në Universitetet italiane. Shoqata sinjalizon gjithashtu edhe "problemet e hasura me pyetjet mbi kulturën e përgjithshme, apo mbi kiminë e biologjinë, për shkak të dallimeve të mëdha që ka mes programeve të studimit në vende të ndryshme".

Këta "mjekë të dështuar që në nisje" janë tashmë "në pritje për të mësuar se ç'do të bëhet me vendet e mbetura bosh në universitete. Po shpenzojnë shuma të mëdha për xhepat e tyre për të qëndruar në Itali dhe duan të dinë nëse ekziston ndonjë shpresë që të regjistrohen. U bëj apel ministrit të Shëndetësisë, Ferruccio Fazio, dhe të Arsimit, Mariastella Gelmini, që të gjejnë zgjidhje të tilla që të mos dëmtojnë studentët e huaj dhe t'u sigurojnë atyre një hapësirë studimi", përfundon Aodi.

# S'ka leje qëndrimi për kërkim pune për të diplomuarit e huaj

**Ministria e Brendshme: "Nuk mund t'u jepet dokument qëndrimi për pritje punësimi".  
Gëzim Gezka (Asal): "Ligj i padrejtë. Kështu shumë studentë kthehen në klandestinë"**


**M**e të mbaruar universitetin, studentët e huaj që nuk gjejnë punë pa u skaduar leja e qëndrimit për studime duhet të kthehen në atdhe. Nëse nuk e bëjnë (dhe kjo është mëse e mundur) kthehen në imigrantë të parregullt.

konvertim të tillë është më parë e nevojshme të bëhet një modifikim specifik legjislativ".

Të sapodiplomuarit që duan të qëndrojnë në Itali duhet të gjejnë menjëherë një punë, para se të skadojë leja e tyre për studime. E vështirë, sidomos në situatën e sotme ekonomike.

Ndryshe trajtohen nga ligji i imigra-

kryetar i shoqatës së studentëve shqiptarë të Lecces, Asal. "Pasi studion për vite me radhë në Itali, është vështirë të kthehesh në shtëpi. Kështu që, atë që nuk gjen menjëherë punë, e pret klandestiniteti". Dhe kështu ndodh, nënvizon Gezka, kryesisht për ata që vijnë nga vendet më të varfra. "Kam parasysh kolegët e mi afrikanë



E ka sqaruar Rodolfo Ronconi, shefi i drejtorisë qendrore të Imigracionit të Policisë së kufirit të ministrisë së Brendshme, me një qarkore kushtuar të sapodiplomuarve jokomunitarë. Ndonjë kuesturë ngrinte çështjen e "lëshimit të të një lejeje qëndrimi për pritje punësimi edhe në favor të atyre studentëve të huaj që kanë përfunduar me sukses studimet universitare por që nuk kanë nisur doktoraturë apo master universitar të nivelit të dytë". Përgjigja është jo. Ronconi është i mendimit se "për të bërë një

cionit ata që mbarojnë një master apo doktoraturë: në këto raste, kur u skadon leja e qëndrimit për studime, ata mund të regjistrohen në listat e punësimit dhe të marrin një leje qëndrimi për pritje punësimi, që u jep të paktën gjashtë muaj kohë për të gjetur një punë.

"Përveç dallimit të padrejtë që bëhet mes atyre që mbarojnë universitetin dhe të tjerëve që mbarojnë një master apo doktoraturë, duhen pasur parasysh edhe pasojat e një praktike të tillë" vë në dukje Ergys Gezka,

apo amerikano latinë. Familjet e tyre kanë investuar shumë për t'i dërguar në universitet në Itali. Për të, të kthehen në shtëpi si të papunë, me një diplomë që vështirë se do të mund të përdorin në atdhe, është një dramë e vërtetë".

Ergys Gezka dhe kolegët e tij, në fund të fundit, nuk duan shumë: "Vetëm pak kohë për të kërkuar punë në Itali. Besoj që të gjithë studentët e meritojnë këtë shans".

Elvio Pasca

## GJIROKASTËR

### Për herë të parë dy shkolla të qytetit jugor do të kenë klasa dygjuhëshe, shqip – italisht Në nëntëvjeçare do të mësohet edhe gjuha italiane krahas shqipes

*Në klasa të shkollave 9-vjeçare në qytetin e Gjirokastrës, nxënësit me një mesatare të notave mbi 7, do të mund të mësojnë gjuhën italiane.*

*Kështu, Gjirokastra do të ketë për herë të parë dy klasa dygjuhëshe shqip - italisht, njëra në shkollën 9-vjeçare "Koto Hoxhi" dhe tjetra në shkollën "Urani Rumbo". Krijimi i mundësive për mësimin e gjuhës italiane në këto shkolla, do të shërbejë për të gjithë ata që duan të studiojnë në Itali.*

*Në këto klasa, sipas Teodor Bilushit,*

*pedagog i gjuhës italiane në Universitetin e Gjirokastrës, mund të regjistrohet çdo nxënës i klasës së gjashtë dhe që ka një mesatare të notave mbi 7.*

*Pas përfundimit të ciklit 9-vjeçar, studimet do të vazhdojnë në sistemin dygjuhësh në gjimnazin "Asim Zeneli", ku edhe po përgatitet infrastruktura e nevojshme, në mënyrë që lëndët në gjimnazin e Gjirokastrës ku do vazhdohen studimet, të jepen nga mësues shqiptarë dhe italianë. Me përfundimin e gjimnazit,*

*nxënësit do të kenë mundësi të ndjekin studimet si në universitetet italiane, ashtu edhe në ato shqiptare, ndërkohë që nxënësit me mesatare të lartë, do të përfitojnë bursa studimi nga ministria e Jashtme italiane.*

*Prezantimi zyrtar i këtij programi të ri studimi u bë nga Konsulli i Përgjithshëm italian në Vlorë, Sergio Strozzi dhe Drejtori shkollor i Ambasadës Italiane në Tiranë, Vito Stiliani.*



A Torino con  
un guasto  
all'auto

**TRASFERIMENTO VELOCE  
DI DENARO IN ITALIA A PARTIRE  
DA**  
**€ 4.90**

Riprendi il viaggio  
verso Firenze

Sorprendi i tuoi cari su  
[www.4-90forbetter.it](http://www.4-90forbetter.it)



**Regala momenti di gioia ai tuoi amici ed alla tua famiglia su  
4-90forbetter.it ed otterrai un grande impatto con un piccolo gesto**  
Offerta valida dal 22.11.2010 per i Paesi zona EURO.

• **Trasferimento di denaro** •

**WESTERN  
UNION**  
*moving money for better*

Il denaro è generalmente disponibile in minuti compatibilmente ai termini e condizioni del servizio, inclusi gli orari di apertura dei punti vendita degli Agenti e le differenze di fuso orario. Prendere visione del modulo To Send per le condizioni del servizio.